



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 DHJETOR 2021**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 28. DECEMBRA 2021. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2021**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin me energji

## **Dnevni red**

1. Razmatranje odluke vlade Kosova o vanrednim merama za snabdevanje električnim energijom

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Po e fillojmë këtë seancë të jashtëzakonshme. Kjo seancë e jashtëzakonshme, të nderuar deputetë, është thirrur sipas kërkesës së 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Para se të fillojmë seancën, edhe një herë ju kisha lutur që për shkak të pandemisë COVID-19 t'i përdorni maskat dhe ta ruani distancën nga njëri-tjetri. Këto masa gjithmonë na i rekomandon Instituti i Shëndetit Publik.

### **1. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin me energji**

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës më 24 dhjetor, në pajtim me nenin 25 të Ligjit nr. 05/L-081 për energjinë e ka proceduar në Kuvend për miratim vendimin për masat e emergjencës në kufizimin e energjisë. 40 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme për ta shqyrtuar dhe miratuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë.

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për masat e emergjencës në furnizim me energji dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Ia japim fjalën ministres së Zhvillimit Ekonomik, Artane Rizvanolli, që ta arsyetojë vendimin e Qeverisë.

Atëherë, e ftojme ministren Artane Rizvanolli që ta marrë fjalën dhe ta arsyetojë vendimin e Qeverisë.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Sistemi elektro-energjetik i Kosovës aktualisht është duke u përballur me vështirësi të theksuara si pasojë e rritjes së theksuar të konsumit të energjisë në vend, pamjaftueshmërisë së gjenerimit të brendshëm për ta mbuluar konsumin dhe krizës globale energjetike që ka rezultuar me rritje enorme të çmimeve të energjisë elektrike në bursa ndërkombëtare.

Vështirësitë në furnizim me energji elektrike janë paraqitur sidomos gjatë muajit dhjetor, për shkak të avarive të shkaktuara në gjeneratorët e termocentralit Kosova A dhe Kosova B, ku njëkohësisht kemi pasur edhe rritje të theksuar të konsumit të energjisë elektrike. Duke pasur

parasyssh se rreth 85% e konsumatorëve në Kosovë janë konsumatorë shtëpiakë, kërkesa për energji elektrike është rritur dukshëm si rrjedhojë e uljes së temperaturave. Si rrjedhojë e konsumit të shtuar, mund të paraqiten pasoja të shumta, siç janë: amortizimi i asetëve, imbalancet në sistemin interkonektiv, si rrjedhojë e mosbalancës së theksuar në mes të kërkesës dhe ofertës së energjisë elektrike në vend aktualisht janë duke u shkaktuar, në fakt në kohën kur është propozuar vendimi para pesë ditësh kanë qenë duke u shkaktuar imbalance të mëdha ndaj sistemit interkonektiv me rreth 40% të konsumit në Kosovë të tërhequr nga sistemi interkonektiv i Evropës kontinentale në formë të devijimeve.

Për këtë KOSTT-i ka marrë edhe vërejtje nga ENTSO-ja, të cilët kanë kërkuar në mënyrë strikte ndërprerjen e menjëhershme të devijimeve ndaj rrjetit interkonektiv evropian. Për të ruajtur integritetin e sistemit dhe kontribuar në balancimin e sistemit elektro-energjetik të Kosovës dhe atij evropian, Qeveria autorizohet përmes Ligjit Nr. 05/L-081 për energjinë, neni 25, që të shpallë masat e emergjencës në furnizim me energji. Një shpallje e tillë nuk do të thotë që merren masa kufizuese menjëherë, mirëpo një vendim i tillë i mundëson Qeverisë marrjen e masave që kanë të bëjnë me vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorë ose vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Aprovimi i një vendimi të tillë sipas nenit 25.2 i mundëson Qeverisë të fillojë së zbatuari masat menjëherë që në datën e aprovimit të vendimit nga Qeveria, megjithëse i njëjti duhet të aprovohet edhe nga Kuvendi i Kosovës brenda shtatë ditësh. Propozim-vendimi parasheh që këto masa të vendosen për një periudhë kohore deri në 60 ditë nga hyrja në fuqi i këtij vendimi. Megjithatë, Kuvendi i Kosovës mund të vazhdojë këtë afat për periudhat e njëpasnjëshme prej 30 ditësh me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

Propozim vendimi parasheh themelimin e Komitetit Teknik Emergjent, i cili udhëhiqet nga Ministria e Ekonomisë, e që në përbërje ka aktorët kryesorë të sektorit dhe më gjerë dhe mund të ketë edhe përfaqësues të institucioneve ose ekspertëve të ndryshëm. Komiteti Teknik emergjent i identifikon dhe i rekomandon masat emergjente ministres së Ekonomisë, të cilat pastaj shpallen me vendim në varësi të nevojës dhe të situatës për furnizimin me energji elektrike. Masat, të cilat vendosen, cilado qofshin ato, janë të përkohshme, të cilat kanë për qëllim zbutjen e krizës së furnizimit me energji për kohën sa zgjat kjo gjendje emergjente për furnizim me energji. Masat e marra publikohen nga ministria, dhe për të njëjtat njoftohet edhe sekretariati i Komitetit të Energjisë.

Edhe një here, në fund, për sqarim, duke qenë se në opinion ka pasur paqartësi në lidhje me këtë, vendosja e masave emergjente dhe aprovimi i këtij vendimi nuk do të thotë që masat vendosen menjëherë, por kjo ia jep të drejtën Qeverisë që në bazë të rekomandimeve të Komitetit Teknik Emergjent të ndërmarrë masa sipas nevojës në masën që është e nevojshme dhe për kohëzgjatjen

që konsiderohet e domosdoshme për të tejkaluar krizën më lehtë. Andaj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ju ftoj që ta aprovoni këtë vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Kush e arsyeton raportin e komisionit? Kryetari i komisionit, deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Qeveria e Republikës së Kosovës më 24. 12. 2021 mori Vendimin nr. 01/051 të datës 24. 12. 2021 për masat e energjisë në furnizim me energji dhe i propozoi Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në bazë të Ligjit për energji.

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 25 të Ligjit nr. 05/L-081 për energjinë, në mbledhjen e mbajtur më 24. 12. 2021, pasi e shqyrtoi Vendimin e Qeverisë nr. 01/051, më datë 24. 12. 2021, për masat e energjisë për furnizim të energjisë vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim: të miratohet vendimi i Qeverisë për masat e emergjencës në furnizimin me energji. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje me 40 nënshkrime ka ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme, gjithashtu i njëjti rekomandim i Qeverisë ka shkuar edhe në Komisionin për Ekonomi, siç e ceku edhe kryetari i komisionit dhe ka marrë mbështetjen e komisionit.

Ajo çka ne kemi mbështetur natyrisht është që vendimi i Qeverisë t'i silltet Kuvendit brenda tri ditëve pas miratimit në Qeveri. Ky vendim është sjellë menjëherë ditën kur është marrë vendimi në Qeveri, gjithashtu Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka shtatë ditë kalendarike që të miratojë këtë vendim. Në rrethanën e krijuar me mungesën e furnizimit me energji elektrike, në të cilin një bllok i Kosovës B është jashtë funksionit, në të cilin mbi 40% të rrymës, e cila konsumohet në Kosovë tërhiqet nga interkoneksioni, duhet të shtohen masat, të cilat ia mundësojnë fushëveprimin Qeverisë në vendimin që e ka marrë.

Më e rëndësishmja është vendosja e kufizimit mbi aktivitetin komercial që ka të bëjë me burime të caktuara të energjisë, vendosja e kushteve të veçanta komerciale, kufizimin e tregtimit me

energji, siç e kemi pare, e kemi një prodhues në Kosovë që vjen nga prodhimi i energjisë, nga Ujmani, energjia elektrike, të cilit sot eksportohet si rrjedhojë e një kontrate të lidhur në vitin 2019, të vazhduar për vitin 2020 dhe 2021, ndërsa e vetmja mënyrë për të kthyer gjithë prodhimin e energjisë elektrike të Kosovës për furnizim në Kosovë është që të kemi një rrethanë, e cila përcaktohet me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në sektorin e energjisë.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që kjo situatë, e cila është krijuar aktualisht në Kosovë, të ketë një komunikim dhe një informim të drejtë, natyrisht edhe me këtë rast ministria, edhe pas shpalljes së gjendjes nga Kuvendi duhet të marrë masat kufizuese, por edhe përmes mjeteve të informimit publik t'i paraqesë ato sekretarit të Komitetit për Energji dhe opinionit publik në Kosovë. Si grup parlamentar e mbështesim këtë vendim të Qeverisë dhe natyrisht i ftojmë të gjitha grupet parlamentare që ta mbështesin dhe ta miratojnë këtë vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të PDK-së, deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë,

Sot kemi para nesh një vendim të Qeverisë shumë të vonuar, i cili do të duhej të ishte planifikuar që në vjeshtën e hershme dhe i cili do të na pasqyronte bashkë me vendimin e shkurtër, jo kështu siç ka ardhur, edhe një arsyetim pak më të thuktë për sfidat, rrethanat dhe problemin që ka ardhur që ne sot të pajtoheshim apo të mos pajtoheshim për një krizë emergjente të vendit.

Është e vërtetë e madhe që edhe në seancën e kaluar ne kërkuam që vendi ta shpallë gjendjen emergjente energjetike, por mbi bazën e arsyeve, mbi bazën e analizave, mbi bazën e fakteve dhe mbi bazën e veprimeve që janë ndërmarrë paraprakisht apo që nuk janë ndërmarrë paraprakisht. Ligji për energjinë e definon qartë, edhe hapat që e nxjerrin shtetin nga situata krize emergjente, por edhe veprimet juridike, të cilat duhet të ndërmarrë shteti dhe qeveria për të vepruar karshi të gjithë shkelësve, karshi të gjitha ndërmarrjeve, karshi të gjithë individëve, të cilët e kanë ndikuar këtë situatë krize direkt apo indirekt dhe si rezultat i saj, sot taksapaguesit tonë po paguajnë kosto të lartë dhe si rezultat i saj, barra kryesore po bie mbi taksapaguesit dhe konsumatorët tanë, gjegjësisht mbi qytetarët tanë.

Pra, në këtë relacion kemi një shmangie dhe një ikje të jashtëzakonshme, vërtet të jashtëzakonshme të institucioneve të shtetit që bëhen në raport edhe me ligjin, edhe me kompetencat që ka Qeveria, edhe me veprimet juridike e operacionale që do duhej t'i merrte gjatë kësaj faze. Më lejoni që këto që po i them t'i arsyetoj me disa fakte: ne kemi parë edhe ministren, edhe kryeministrin në disa konferenca shtypi duke fajësuar proceset historike, pa

dashur të ndalem te to. Por, nuk kemi parë asnjëherë një analizë dhe një fakt pse erdhi te rënia e bllokut të Termocentralit Kosova B, përveç asaj duke thënë që është i vjetër. E, unë ju them që mbështetur në raportet zyrtare të punëtorëve dhe inxhinierëve të KEK-ut, kjo krizë ose kjo rënie nga sistemi i bllokut të B-së është paralajmëruar teknikisht nga kuptimi inxhinierik ditë më parë.

Pra, saktësisht raporti i punës së ekipeve inxhinierike nga data 18. 10. 2021 në ndërrimin e dytë dhe në ndërrimin e tretë janë të evidentuara prishjet, rrjedhjet apo ndodhjet teknike në këtë bllok, i cili sot është jashtë funksionit. Pra, ka një rrjedhje të ujit, i cili në kuptimin inxhinierik nuk do të duhej toleruar në asnjë mënyrë që të vazhdojë puna e tij dhe në ndërrimin e dytë ka pasur brenda orës rreth 0.37 metra kub ujë që ka rrjedhur.

Vazhdon e njëjta rrjedhje edhe në ndërrimin e tretë dhe, për çudi, nuk kemi asnjë veprim menaxhues, inxhinierik që ky bllok të ndërpritet, të sanohet dëmi sa ishte i vogël e të mos dalë jashtë funksionit. Pra, në kuptimin inxhinierik, menaxhues, menaxhmenti i KEK-ut, drejtori i KEK-ut dhe ekipet profesionale do të duhej me kohë të reagonin. Kanë qenë nën presion politik që të mos reflektojnë në këtë kohë politike, zgjedhore dhe duhet të shfrytëzohet çdo kapacitet i mundshëm prodhues, jashtë parametrave inxhinierikë dhe teknikë, duke i futur në funksion që s'ka ndodhur, shumë pak ka ndodhur në historinë 20-vjeçare që plus të futen edhe tri blloqe të A-së në të njëjtën kohë, të cilat në kuptimin profesional është jashtë logjikës, duke llogaritur të gjithë parametrat teknikë dhe teknologjikë që ka edhe A-ja.

Pra, mosveprimi në B në kohë në kuptimin inxhinierik sjell pastaj pas disa ditësh, pra dalje nga sistemi, i cili sot po na kushton me një krizë të jashtëzakonshme dhe me qindra miliona dëm buxhetit të vendit, e që po reflekton direkt te taksapaguesit. Pra, kjo nuk arsyetohet ndryshe veç paaftësi direkte menaxhuese, paaftësi organizative dhe ndikim politik në një ndërmarrje publike, e cila e ka bartur barrën dhe e mban jashtëzakonisht mirë në situata tepër të vështira.

Pra, ne sot do të duhej të kishim një analizë pse ka ndodhur dalja e sistemit të B-së nga funksioni dhe mosveprimi, do të duhej ta kishim një analizë pse sot ndahen kaq shumë mjete kur nuk ka bord. Zyrtarisht KEK-ut dy herë nga gjashtë muaj i është vazhduar dhe ligji nuk e lejon më që të punojnë ndërmarrjet publike me borde të përkohshme. Nga data 21 nëntor i këtij viti KEK-u menaxhohet pa bord, nuk ka aksionarë a përfaqësues aty, ka vetëm një të deleguar të kryeministrit, të emëruar jashtë çdo procedure transparente, ka një menaxhment politik, i cili i shkakton edhe këto probleme teknike dhe inxhinierike, sepse ka direktivë politike që të prodhojë dhe ta mbulojë, ta kamufltojë popullizmin politik në sektorin e energjisë.

Pra, do të duhej para se të miratojmë këtë vendim të Qeverisë, t'i kishim edhe këto të dhëna që sapo i përmenda, sepse janë ndikuese direkte në realizimin e këtyre projekteve. Por, do të duhej ta kishim edhe një fakt tjetër që ministrja Rizvanolli dhe kryeministri, pasi që nuk ka ardhur këtu, si ka mundësi, është e vërtetë e madhe tash na ka zbuluar diçka kryeministri që nuk po u ruajka

rryma në frigorifer, por unë i them kryeministrit që gjatë vitit që po e lëmë ka eksportuar Kosova rrymë 58 milionë euro. I kemi statistikën, Qeveria duhet të na tregojë se a mund t'i planifikonte këto 58 milionë euro, sipas raporteve zyrtare 730 000 MW orë energji ka eksportuar Kosova. Dhe, përsëri Qeverinë e zë të papërgatitur, "faj ka Qeveria X, Qeveria Y, ministri X, ministri Y historik". Pra, ku mbetën paratë e eksportuara brenda këtij viti kalendarik? Si nuk pati mundësi të planifikoheshin? Ne ua lamë 400 KW-shin, ne ua bëmë pjesën e bashkëpunimit me Shqipërinë, pse nuk uleshit të bisedoni në pikën e verës, kur ne kemi eksportuar energji dhe ata sot kanë jashtëzakonisht energji solide të ujit dhe ta bënim këtë kompensim.

Pra, a mund të më thoni ku kanë shkuar mjetet e eksportit dhe ku po shkojnë mjetet sot? Sa është ndikimi i mjeteve që keni ndarë, 20 milionë për KEK-un dhe sa e prek konsumatorin? Nëse nuk e prek dhe nuk keni shifra që e prek direkt, ku po shkojnë mjetet? Ku po shkojnë subvencionet në sektorin e energjisë, kur asnjë impakt, as shkencor, as publik e as juridik nuk e kemi që konsumatori sot po e pranon këtë "dorë të Qeverisë". Praktikisht, jemi non sens duke larguar paranë tonë, duke shkuar përmes portës së dytë dhe ndihmuar ndërmarrjet e tjera të sektorit privat, që pajtohemi që e kanë monopolin, pajtohemi se nuk është mirë, pajtohemi që jemi të gatshëm ta diskutojmë edhe atë temë, pajtohemi se duhet hapur tregu energjetik, por mos harroni, se po në këtë mandat, ama 3 ditë a 4, nuk mund ta them me datë të saktë, pa u themeluar Kuvendi i Kosovës, pikërisht VV-ja dhe disa aktorë të saj kanë ndikuar publikisht, lexoni portalet, lexoni Zyrën e Rregullatorit, këqyrni ku kanë thënë "s'ka treg, sepse po ngritën çmimet dhe nuk fillon procesi i liberalizimit të tregut të energjisë".

Pra, para nëntë muajsh keni qenë të zëshëm publikisht kundër hapjes së liberalizimit të tregut. Do të ishte situatë krejt tjetër, krejt rrethana të tjera sot, sikur të fillonte liberalizimi i tregut të energjisë para nëntë muajsh, që ju e keni ndërprerë, keni interferuar jashtëligjshëm edhe atëherë politikisht te Zyra e Rregullatorit dhe nuk kemi liberalizim të tregut, e sot nuk mund t'i parashikojmë pasojat, qoftë pozitive apo negative. Pra, kështu që si e keni sjellë vendimin sot, ju përsëri po doni ta legjitimoni, por unë kam kërkuar ta sillni një vendim të tillë, por të interpretohet komplet Ligji i energjisë, nenin 25 dhe nënnetet e tij. Pika 8 e nenit 25 e thotë: "Duhet edhe veprime juridike për mosveprim të të gjithë atyre që politikisht apo inxhinierikisht e sabotojnë sektorin". E keni shmangur atë, sepse keni bërë pagesa jashtë çdo norme ligjore, derisa të miratohet ky vendim në sektorin e energjisë. Keni bërë dhjetëra milionë euro qarkullim pa bord të KEK-ut, pa aksionarin, pa shumëçka, duke shkelur çdo procedurë. Keni bërë transaksione dhe marrëveshje të përkohshme. Nuk gjen shtet në rajon që e blen rrymën sot për sot, e ju po, e blini sot për sot, se po ta kishit blerë një vit a gjashtë muaj më herët, kontratën, jo të ruhet në frigorifer, se nuk punon as frigoriferi pa rrymë, nëse nuk e dini, po të bëhej kontratë afatgjatë, sot do ta kishim një çmim krejt tjetër.

Sot për sot është shtatë herë më i lartë çmimi kur e blen në treg. Pra, ju e keni sjellë situatën të blini sot në mëngjes energji për pasdite. E këtu pastaj lëvizin çmimet deri në 250 e 400 MW për



KW orë. Prandaj, ju kërkoj mirëkuptim, po ky vendim që ka ardhur sot duhet të rikthehet, të plotësohet dhe të vendosen mostrat të tjera shtesë, të cilat do të jepnin përgjegjësi e llogari për këtë periudhë sa jeni ju, edhe për pjesën tjetër, pse jo? Jemi shumë të hapur, çdo lloj kontrate ta diskutojmë dhe të veproni. Por, tash krejt këtë barrë e bart konsumatori. Ju vetëm po e legalizoni...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Po! Urdhëro! Një gjysmë minutë.

FERAT SHALA: Pra, vendimi qysh e keni sjellë sot, me dy pika, po doni ta legalizoni ndërprerjen, po doni ta legalizoni paligjshëm, pa logjikë, ta dëmtoni konsumatorin. Po doni t'i mbronni praktikisht disa operatorë, që tashmë keni hyrë në transaksione me takime, qoftë në Shkup, qoftë në Stamboll. Këtë s'mund ta mohoni. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, kryetari i këtij subjekti, deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar Konjufca!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja e zotërinj,

Kosova është në krizë energjetike, është në terr, reduktime, agregatë e qirinj. Aq krizë sa që bëri lajm sërish, për të keq, natyrisht, në mediat ndërkombëtare. E kur bëhesh lajm për të keq në media ndërkombëtare, do të thotë se kriza këtu është më e dalluar, është më e veçantë. Tani, të gjitha vendet e Evropës janë përballur e po përballen me krizën energjetike. Shkurtimet në furnizim me gaz, rritja e çmimeve të thëngjillit, e rritja e konsumit të gjithmbarshëm gjatë dimrit, e ka vendosur pothuajse secilin shtet evropian në nivele më të larta konsumi se sa prodhimi.

Pra, në Evropë shtetet po konsumojnë më shumë energji se sa që prodhojnë. E sepse konsumojnë më shumë se sa prodhojnë, duhet të njëjtat të blejnë energji; pra të importojnë. Te të gjitha këto vende, furnizimi i energjisë ekzekutohet kryesisht nga kompani private. Pra, natyra publike ose private e furnitorëve nuk e diferencon sasinë e furnizimit.

Ajo çfarë e diferencon sasinë e furnizimit në Evropë është angazhimi i vetë qeverive, i vetë shteteve. Ato nuk janë spektatore, edhe më pak ankuese. Çdo qeveri në Evropë, nga fqinjët tanë në Shqipëri e Maqedoni të Veriut, deri tek ato në Francë e Gjermani, janë marrë me urgjencë me temën e energjisë në momentin e parë të lindjes së krizës, në korrik të vitit 2021.

Pra vetë qeveritë, në momentin e parë të pasjes krizë kanë filluar të merren me lehtësim, me çmimin e sasisë së furnizimit e me përballjen e qytetarëve të tyre me mungesë të furnizimit të

energjisë. S'kanë hedhur faj, s'janë ankuar për kapacitete që edhe ata s'i kanë, sepse konsumojnë më shumë se sa prodhojnë; por kanë vepruar shpejt. Se kanë vepruar shpejt, kanë bërë dhe zgjidhje.

Prandaj sot të gjitha këto shtete i furnizojnë qytetarët e tyre me ngrohje e me energji elektrike. Kosova s'mund ta bëjë një gjë të tillë, pra s'mund të japë furnizim bazik dhe bëhet lajm ndërkombëtar. Prandaj, kriza këtu është e veçantë. Nuk bëhet lajm ndërkombëtar Shqipëria e Maqedonia e Veriut, dy fqinjët tanë, por Kosova. Sepse, si e para, ashtu dhe e dyta, kishin shpallur gjendjen e emergjencës në tetor të këtij viti, kur edhe çmimet ishin më lirë, edhe kriza ishte më e lehtë.

Këto dy vende fqinje, sikurse çdo qeveri e përgjegjshme tjetër në Evropë, ishin marrë me krizën. Aq në detaje janë marrë me krizën, sa që njëri nga ta ka blerë madje edhe thëngjill prej Kosovës. Ne sot jemi në dhjetor. Në fund të dhjetorit, praktikisht. 4 ditë pa përfunduar viti, e gjashtë muaj pas nisjes së krizës. Tek sot, 3 muaj pasi vendet e rajonit janë marrë me këtë krizë e 5 muaj pasi ministrat e vendeve evropiane kishin trajtuar kolektivisht këtë temë, ne kemi nisur t'i dëgjojmë masat e Qeverisë, me 6 muaj vonesë. Tani kjo s'është parapërgatitje, por është menaxhim krize. E kur menaxhon krizë, s'mund të kesh rezultat të mirë. Sepse, të dashur qytetarë, Qeveria jonë, popullsitë, siç është, verës kur të tjerët merreshin me problemin e energjisë e kur çmimet e energjisë rriteshin gjithandej, kjo Qeveri shpërndante parulla nëpër Evropë se e ka zhvillimin më të madh në Evropë, aq të lartë sa që po e arrijmë edhe Kroacinë.

Sot, kur pas një dekade furnizimi stabil - reduktimet, terri e agregatët na u kthyen nëpër rrugë e nëpër shtëpi, kur bizneset po e ndalin prodhimin, sepse nuk kanë as diçka bazike, si rrymën, kryeministri që i ka krejt e që s'është këtu, na thotë "rryma s'blihet, sepse s'konservohet në frigorifer" dhe për këtë, merreni me mend, sikurse për çdo dështim tjetër të tij, fajtorë janë krejt, secili përveç këtij që është në pushtet. Dhe, natyrisht, secilit tjetër sot rreth tij, që 8 vjet më parë kishte falë distribucionin për kurrjë, distribucionin dhe 4 hidrocentrale me të.

Një kryeministër, ani pse me profesion inxhinier, ka zgjedhur popullizmin si mjet. Po u flet masave militante të tij. Kjo tani është më shumë se padituri, është krizë e tij, e qeverisë së tij, e së këndejmi, e gjithë vendit që ai e drejton. Sepse, jam i bindur se ai duhet ta dijë, e nëse nuk e di si inxhinier, ta kthejë diplomën menjëherë në Universitet, se rryma, çmimi i rrymës kontraktohet, rezervohet, çmimet fiksohen. Se, sikurse grurin, naftën e çdo mall tjetër në treg, mund ta blesh dhe energjinë elektrike me çmime që nuk ndryshojnë. Por, për të bërë një gjë të tillë, duhet të veprësh në kohë, jo i fundit në Evropë, po në kohë. E se energjia elektrike mund të blihet e të fiksohet, kryeministri s'ka pse të shkojë larg, në fakt Ibër-Lepenci, ndërmarrja publike e tij, shet sot me çmim fikse prej 40 eurove për megavat. Blen energjinë me 600 euro, por e shet me 40. Kur po shet, po u konservuaka në frigorifer, po për të blerë, s'po bëka të blihet energjia.

E vërteta është se Qeveria e Kosovës e ka injoruar kërkesën e ekspertëve dhe ndërmarrjeve energjetike në vend me muaj. Ajo nuk i është përgjigjur asnjë institucioni energjetik në vend, as nuk ka ndjekur hapat e vendeve të tjera, që kanë mundur të shërbejnë si shembull i reagimit të shpejtë. Sa për ilustrim, KOSTT-i, operatori i sistemit, transmisionit dhe tregut, operatori ynë publik, gjatë dy muajve të fundit ka devijuar rrymë në vlerë prej 30 milionë eurove nga ENTSO-ja, shumë që tani duhet të paguhet dhe të kthehet prapa, shtu kësaj dhe 20 milionë euro të transferuara nga Qeveria për import, dhe janë 50 milionë euro pa ndonjë efekt. 50 milionë euro të dhënë nga Kurti, pa ndonjë efekt energjetik. Ky është bilanci i tanishëm deri më sot. Kështu ndodh kur reagon i fundit në Evropë. Kështu ndodh kur reagon 4 ditë pa përfunduar viti, në mes të dimrit për krizën energjetike që ka ardhur tash e 6 muaj në Evropë.

Qeveria e vendit ka mundur të bëjë më shumë, natyrisht edhe të bëjë përgatitjet për mirëmbajtje të termocentraleve, që zakonisht gjithmonë ka ndodhur gjatë verës e jo në mes të dimrit, sepse kur s'i mirëmban verës, normalisht që ka krizë dimrit.

Ka mundur të reagojë edhe në organizimin tarifor shumë më të mirë, që do të ndikonte në kursimin e energjisë, apo në fushata sensibilizuese, që do të nisnin me kohë, e edhe më shumë në organizimin e konsumit industrial, që prodhimi të koordinohet.

Ne diskutojmë tek sot për emergjencë, kur 9 shtete të BE-së, Belgjika, Çekia, Gjermania, Italia, Irlanda, Portugalia, Spanja, Estonia e Qipro kanë muaj të tërë që kanë reduktuar e hequr tërësisht TVSH-në për konsum energjetik. Kryeministri ynë u thotë qytetarëve “rryma është e lirë”, si parapërgatitje për rritje të çmimit, pa ndonjë efekt lehtësues më pas. Ne diskutojmë sot për krizën e energjisë, kur 10 shtete të BE-së kanë rregulluar çmimet e tarifat si masë e detyrueshme kursimi, ne vazhdojmë të rekomandojmë me kursime “joysticku”. Kur 13 shtete të BE-së kanë siguruar transfere për grupet e rrezikuara, Qeveria jonë ankohet e vëzhgon, barabartë me grupet e rrezikuara.

Tek sot, më 28 dhjetor, 6 muaj pas nisjes së krizës energjetike në rajon, Qeveria na vjen me kërkesa emergjente, me plane kursimi. Të dashur qytetarë, mos pritni ndryshime të mëdha në energjetikë. Dikush që kundërshton edhe termocentrale qymyri, edhe termocentrale gazi, edhe tarifa solare, edhe ndërtimin e hidrocentraleve, pra dikush që refuzon thëngjill, ujë, diell e gaz, pra çdo burim të energjisë së mundshme - s'ka se si t'i japë projekte të mëdha, transformuese vendin.

Ata që e kanë kundërshtimin si mjet, s'mund të kenë zgjidhjen si qëllim. Në fund të ditës, në programin qeveritar të prezantuar në këtë Kuvend, tema e energjisë mbulohet me gjysmë faqe tekst. E kur energjinë e mbulon me gjysmë faqe tekst, s'ke se si të mos e mbulosh krizën me një qebe. Prandaj, deri në pranverë le të dëgjojmë përralla populliste e ankuese për 20 vjet, e tregime militanteske për rrymën në frigorifer. Është më e lehtë. Popullizmi këtë ka. Arsyetime përplot,

ankesa edhe më shumë. Qeveri, jeni për të bërë zgjidhje, e Kosova të mos e pretë vitin 2022 e vetme në terr. Faleminderit!

KRYETARI: Tash radhën e ka kryetari i grupit të AAK-së, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Siç jeni në dijeni, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës duke parë gjendjen e rënduar të krizës energjetike në vend, dy javë më parë, pra më 13 dhjetor 2021, ka kërkuar një debat parlamentar për të adresuar këtë çështje, që mendojmë se është çështja më e rëndësishme dhe më jetike për qytetarët e Kosovës.

Paraprakisht kësaj, dua t'ju njoftoj, si juve, Kabinetin qeveritar dhe qytetarët e Kosovës, se më 6 tetor të këtij viti kryetari Ramush Haradinaj u është drejtuar kryeministrit dhe Qeverisë dhe, ndër të tjera, po e citoj, ka kërkuar “që pas paralajmërimeve në krizën energjetike botërore, a do të thellohet kriza energjetike në Kosovë, kur dimë që Kosova ka pak mundësi të destifikimit të energjisë”. Pra, ne po bëhemi gati dy muaj e gjysmë, e kemi ngritur alarmin te Qeveria për ta adresuar këtë çështje, që sot është bërë barra më e madhe për qytetarët e Kosovës.

Ndërkohë, çka kemi sot? Sot, Qeveria e Kosovës, në fakt, me qëllim që ta zbehë dhe ta pengojë iniciativën tonë për një debat përmbajtjesor për krizën energjetike në vend, ka sjellë në Kuvend një vendim, i cili në esencë është dashur të vijë para këtij Kuvendi tash e shumë muaj më parë dhe vendim, i cili praktikisht nuk ka asnjë ndikim te qytetarët e Kosovës, veçse justifikimin e kursit të veprimit të Qeverisë në raport me të gjitha veprimet që do të marrë me shkëputjen dhe ndaljen e rrymës. Pra, përmes këtij vendimi, i nderuar kryetar Konjufca, është ndërhyrë në agjendën e paraparë dhe votuar në seancën e kaluar për zhvillimin e debatit parlamentar dhe në të njëjtën kohë ka ardhur një vendim që nuk është prekur, praktikisht nuk ka vendime të sakta, që do të mund të ndikonin në përmirësimin e situatës.

Kolegë të dashur,

Siç edhe jemi të gjithë në dijeni, Kosova tanimë është duke u përballur me krizën më të rëndë energjetike, që nga koha e shpalljes së pavarësisë së vendit. Qytetarët e Kosovës, ekonomia e Kosovës, bizneset e vogla dhe të mesme, janë duke u përballur me reduktime shumë të ashpra dhe mu në kohën kur temperaturat kanë rënë nën 0 gradë. Ndërkohë, ajo që na bën edhe më të shqetësuar është fakti se Qeveria dhe kryeministri, që është duke u sjellë me një papërgjegjësi totale, është duke injoruar këtë problem madhor, duke tentuar ta bartë përgjegjësinë e dështimit të tij për veprime afatshkurta te palët e treta.

Është për t'u habitur fakti se si ka mundësi që Qeveria, kryeministri i Kosovës, të harrojnë se tash e 15 vjet në Kosovë nuk ka pasur asnjëherë mungesë të energjisë elektrike në këtë nivel, ku qytetarët e Kosovës mbeten pa rrymë, jo dy orë, siç thuhet, mund të ndodhë që dy orë është në Prishtinë, po me nga gjashtë, shtatë e deri në dhjetë orë në ditë. Pra, kryeministri duhet të kthejë memorien e vet një vit më pas dhe të bindet se si ka qenë Kosova dhe si është sot, në aspektin energjetik.

Për më shumë, deri më sot nuk po shohim askund ndonjë veprim, ndonjë strategji konkrete, e cila do të zgjidhte këtë problem dhe kjo, në fakt, po del që është shumë e natyrshme për këtë Qeveri, sepse e njëjta që nga krijimi i saj asnjëherë nuk ka pasur në qendër të vëmendjes qytetarin dhe nuk e ka as sot, kur qytetarët tanë po mbeten pa rrymë në këto temperatura të ulëta.

Kryeministri ka qenë dashur të përkujdeset me kohë që blloqet e termocentraleve A dhe B të jenë të afta për të prodhuar energji elektrike në kohë dimri, në veçanti duke i ditur paralajmërimet që janë dhënë nga këto pozicione, pra nga Kosova A dhe Kosova B. Kjo Qeveri është dashur të jetë shumë më largpamëse dhe të kontraktojë energji elektrike shumë më herët e me çmime të arsyeshme të tregut, dhe jo në këtë mënyrë të shmangë blerjen e energjisë me çmime enorme, sikur është duke ndodhur tani.

Dhe, natyrisht, kryeministri Kurti nuk ka pasur mundësi që t'i bëjë këto veprime, pasi i njëjti, siç thoshte edhe në fushatë, më 13 dhjetor i kam lënë 700 punë anash për t'u dalë në ndihmë kandidatëve për kryetarë, për të marrë pak pushtet në komuna, e që në fakt nuk e mori në nivel lokal. Pra, një kryeministër i cili do të duhej të ishte i krejt qytetarëve të Kosovës, e lë Kosovën në terr, vetëm e vetëm që të fitojë ca vota më shumë.

Kryeministri ynë nuk gjeti kohë që me veprime konkrete të parandalojë krizën energjetike, por që i njëjti gjeti kohë që të bëjë fushatë elektorale në degën e Vetëvendosjes në Republikën e Shqipërisë. Sot, në vend se të kemi një bashkëpunim të ngushtë në këtë krizë me Republikën e Shqipërisë, në fakt nuk kemi komunikim hiç dhe kemi shënuar një çarje të madhe të raporteve Kosovë – Shqipëri.

Nga këto që i thashë më lart, kërkoj nga kryeministri, nga Qeveria e Kosovës, që të jetë shumë më serioz në këtë temë, të marrë përgjegjësinë për gjendjen në vend dhe të ndër marrë veprime konkrete për ta stabilizuar gjendjen me energji në vend. Në fakt, çka ka ndodhur? Kohëve të fundit kanë filluar talljet me qytetarët e Kosovës. E para, me fraza nga zëdhënësi i Qeverisë, ndalni dritat, shkyçni bojlerët, ndalni 'joy-stickat', nxehuni me qebe e kështu me radhë.

E dyta, ngrohja është komoditet. Pra, injorim total i gjendjes sociale psikologjike dhe ekonomike të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

E fundit, për mua më e habitshme, kryeministri kërkon fajtor e s'po ofron zgjidhje. Në fakt, në qoftë se e shohim historinë, ai ka qenë dhe Vetëvendosja kundërshtari më i madh i investimeve në sektorin e energjisë, duke nisur nga Kosova C, Kosova e Re, Contour Global e kështu me radhë, duke i gjetur behane secilit investim, edhe atij të gazsjellësit amerikan.

Zoti Kurti është zotuar se në qeverisjen e tij do të ulë çmimin e energjisë elektrike, sepse sipas tij është tepër e shtrenjtë, kur rrinë mbi këtë energji mbi këto kapacitete që i kemi. Thoshte: Contour Global nuk vjen në shprehje, sepse do të kemi shtrenjtim të rrymës, derisa sot nga pozita e udhëheqësit të Qeverisë, në vend se të gjejë zgjidhje, qytetarëve u thotë troç dhe drejtpërdrejt: po reduktime, po shtrenjtim të energjisë.

Të nderuar deputetë,

Ajo që na shqetëson më shumë se grup parlamentar është fakti se Qeveria dhe kryeministri po ju fton dhe po ecën pas pasojave, por po harron se qytetarët kanë votuar për t'u prirë punëve, t'i parandalojë pasojat dhe të sjellë fitore për qytetarët e Kosovës. Për fat të keq, po dilni se Qeveria po vepron gjithmonë pasi që po ndodhë e keqja, pasi që po ndodhë problemi. Pra, pa një qasje proaktive. Tërë kohën kërkohet një lloj fajtori kujdestar, por jo një zgjidhje e problemit.

Sa i përket vendimit, ne mendojmë se ky vendim duhet të ketë elemente praktike kyçe që lidhen me një plan të veprimit konkret dhe jo një vendim i cili në esencë nuk ka asnjë ndikim në terren. Hapjen e dyerve të investimeve të huaja, por kjo bie ndesh me krejt çka keni thënë më herët ta mbron. Punëtorë e KEK-ut të cilët punojnë në temperatura të ulëta, ditën e natën në pluhur, të ndalet komunikimi joserioz dhe talljet me qytetarët dhe të krijohet një strategji e përbashkët që do të kërkonte një konsensus nacional, për shkak se energjia, investimet në energji, qëndrueshmëria në energji, në qoftë se asgjë tjetër nuk është, është qëndrueshmëri e sigurisë, qëndrueshmëri politike dhe qëndrueshmëri e qytetarëve të Kosovës.

**KRYETARI:** Tash ia japim fjalën kryetarit të PDK-së, deputetit Memli Krasniqi.

**MEMLI KRASNIQI:** I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të respektuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Kosovës,

Përkundër që po bëjmë debat dhe kemi për këtë temë pikëpamje të ndryshme, unë besoj që temën që përveçqë e kemi konkrete, edhe shqetësimin duhet ta kemi të përbashkët për qytetarët e vendit tonë.

Kosova është në krizë energjetike. Kriza energjetike në të cilën po kalon vendi është krizë reale dhe e prekshme për secilin qytetar të Republikës së Kosovës. Mënyra më e drejtpërdrejtë sesi e ndjejnë qytetarët këtë krizë energjetike, janë reduktimet e rrymës, apo restriktionet siç u kemi

thënë në një kohë të lashtë që tash e kemi harruar. Reduktimet meqenëse janë fakt dhe diçka që po e përjetojnë tash e disa ditë me radhë qytetarët tanë, nga ajo që e pashë, nga vendimi që e keni sjellë, krejt çka po kërkoni ju është që të legalizoni shkëputjen e rrymës për qytetarët e Kosovës.

Më shumë se dy javë i ka që ne si Parti Demokratike e Kosovës ju kemi kërkuar që të vini me një vendim për shpalljen e gjendjes emergjente. Po një vendim që bazohet më specifikisht te neni 25 i Ligjit për energji dhe që i përfshin, siç tha edhe z. Shala, të gjitha ato elemente që janë të nevojshme për ta përballuar krizën. Jo vetë një çek të bardhë, siç thuhet, për t'ua ndalur rrymën qytetarëve kurdo që e shohin të arsyeshme institucionet vartëse të Qeverisë.

Megjithatë, përtej kësaj, ajo që neve na shqetëson më së shumti e që kërkon adresim në vete, është diçka që shkon përtej krizës të cilën po e përjetojmë. Ajo që neve na intereson është zgjidhja për krizën, sado e vonuar që është. Prandaj, Qeveria, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet përgjegjëse, përfshirë edhe Kuvendin dhe neve si deputetë, duhet të shohin tek rrugëdalja drejt kësaj zgjidhjeje.

Ka pasur vlerësime dhe mendime të ndryshme për shtegdalje, por fatkeqësisht më së paku për këtë çështje ka menduar Qeveria. E tërë çfarë Qeveria ka provuar të bëjë këtyre ditëve është kërkesa drejtuar qytetarëve për të racionalizuar siç thonë shpenzimin e energjisë, gjë që parimisht në gjendjen e krizës që jemi, ne e kuptojmë. Por, ajo ka dështuar si Qeveri që të bëjë planifikimin e duhur, si në masa rregullatore, ashtu edhe në linja buxhetore. Nuk e kuptoj se cila ka mundur të ketë qenë nxitja që e ka shtyrë Qeverinë të vonohet kaq shumë për të marrë masa me kohë. Por, në fund të fundit, arsyet e Qeverisë nuk na interesojnë. Na intereson zgjidhja. Fatkeqësisht deri më sot nuk kemi parë Qeverinë duke treguar as vetëbesim për të ofruar zgjidhje. E kur nuk ka zgjidhje, atëherë më së lehti është të ketë akuza.

Të nderuar kolegë,

Prandaj është mirë që ta bëjmë një dallim të rëndësishëm. Të gjithë që jeni të pranishëm sot këtu në këtë sallë të Kuvendit të Kosovës, pavarësisht moshës që e keni, i takoni gjeneratave që kanë në kujtesë një formulë në të cilën kemi jetuar në Kosovën e pasluftës: tetë me dy, gashë me katër, tri me tri. Kjo është formula e reduktimeve ose e restriksioneve të rrymës elektrike.

Fatmirësisht pas v. 2008 kjo formulë u harrua shpejt dhe vendi u stabilizua me furnizim të energjisë elektrike, si në pranverë, si në verë, si në vjeshtë, ashtu edhe në dimër. Natyrisht se ai stabilitet nuk ka qenë dhuratë, e nuk ka qenë as rrjedhojë e parullave. Ka qenë manifestim i përkushtimit për ta menaxhuar, për të lexuar m kohë trendët e energjisë, si dhe për të marrë masa adekuate ndaj tyre.

Pikërisht tri gjëra që kjo Qeveri që ka dështuar e po dështon t'i bëjë. Prandaj, megjithëse ju ia keni dalë ta fitoni këtë mandat me premtime se si do të duket e ardhmja, ju nuk mund ta

ndryshoni të vërtetën se si ka qenë e kaluara para ardhjes suaj në pushtet. Pavarësisht se fajin për krizën e sotme energjetike po përpiqeni t'ua lini edhe brezave dhe qeverive të mëparshme, ka një fakt që s'e ndryshoni dot. Para se të vini ju në pushtet, qytetarët e Kosovës kanë pasur dritë. Ndërsa ju i rikthyet sërish në terr. Jeni ju që pas më shumë se 13 vitesh e kthyet në Kosovë formulën e reduktimeve dhe të restriksioneve të rrymës elektrike.

Qytetarët e dinë dhe po e shohin për keqardhje këtë Qeveri, jo veç pse po dëshmohet e paaftë përballë krizës, por edhe pse po janë të papërgjegjshëm përballë përgjegjësisë.

Kryeministri që tri-katër ditë po përpiqet ta heqë një vesvese. Po më vjen keq që aq e merr seriozisht çështjen më të rëndësishme aktuale që s'vjen as sot ta arsyetojë vendimin e tij. Po këtë vesvese po provojmë t'ia heqim edhe ne, ta çlirojmë nga ky tundim. Pra, kriza si kjo në të cilën gjendemi aktualisht kanë vërtet karakter rajonal, kontinental, global zinxhiror dhe për këtë nuk është faji i Albin Kurtit. Askush nuk po e fajëson kryeministrin pse ka krizë energjetike në krejt rajonin dhe në krejt Evropën. Po përgjegjësia ndaj krizës është ajo që e implikon Qeverinë. Këtë përgjegjësi ne po ia kërkojmë kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës. pra, përgjegjësi jo për krizën, po përgjegjësi për zgjidhjen, sepse në mungesë të zgjidhjes, kriza veç thellohet edhe më shumë. Prandaj është dashur të reagohet shpejt sa ka pasur mjaftueshëm kohë.

Meqenëse po përmendet data më 29 shtator, Partia Demokratike e Kosovës për herë të parë ka deklaruar në një komunikatë për shtyp për problemet që do të vijnë me energjinë dhe theksi ka qenë te refuzimi që kjo Qeveri ia ka bërë projektit të gazpërçuesit. Më 9 tetor, në mënyrë decisive kemi kërkuar masa të cilat duhet të ndërmerren, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në tregjet e parakohshme 'forward markets', të cilat ministrja duhet t'ia mësojë Kryeministrit, se ai s'ka faj që s'i di të gjitha. Ju ndoshta mendoni që i di, po nuk i di të gjitha. Dhe t'ia tregojë që ka mundur të ketë kontraktim të mëhershëm, edhe t'i marrë kontratat me çmime kur kanë qenë ndoshta dy herë më të shtrenjtë, e jo gjashtë herë e shtatë herë siç po e paguajmë sot.

Shikojeni rajonin. Më 3 tetor në Republikën e Shqipërisë është shpallur gjendja emergjente, këtë që po e bëjmë ne sot gati tre muaj më vonë. Njëjtë më 12 tetor, edhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut ka dalë hapur para qytetarëve dhe i ka njoftuar për krizën energjetike dhe për masat të cilat është dashur t'i ndërmarrin. E kryeministri ynë është zgjuar prej gjumit gati tre muaj vonesë, e këtë çështje po e trajton me statuse të Facebook.

Për më tepër, përderisa po themi vendet e rajoni janë treguar të përgjegjshme duke mobilizuar kapacitetet dhe resurset, kryeministri ynë është orvatur ta bindë veç popullit që unë s'kam faj. S'kam faj. Krejt çka ka dashur të thotë këto ditë, jo qysh të gjejë zgjidhje, po unë s'kam faj. Nëse i ka mbetur kaq shumë merak, po ia përsëris, nuk ke faj për krizën, po ke faj që s'po gjen zgjidhje. Ke faj që jemi në terr, e ke faj që kemi restriksione të rrymës pas 13 vjetësh.



Kemi kërkuar pra që të ndërmerren masa shumë më herët, por masat janë vonuar. Po e zëmë shembull, pas shumë javësh prej kërkesave që i kemi bërë publike, Qeveria ka marrë vendim t'i ndajë njëzet milionë euro subvencion të importit. Mirë ka bërë, sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Nuk do të ketë.

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Këto njëzet milionë euro, unë nuk besoj që dalin deri në vit të ri me çmimet aktuale në treg. Çka do të bëjmë në 2022-ën? Kjo Qeveri që e miratoi siç e miratoi një buxhet të ashtuquajtur zhvillimor, ka harruar se duhet trajtuar krizën energjetike edhe në v. 2022. E atëherë do ta kemi vështirësinë më të madhe me energji. Nuk e kemi mbërri ende pikën më të rëndë të krizës energjetike. Mos harroni, kriza do të vijë kur të ftohet koha. Kur të ulen temperaturat dhe kur do të ketë mbingarkesa edhe më të mëdha. Kur sot e dimë edhe nga vetë Qeveria që s'ka ymyt para fundit të janarit që të kthehet në funksion as blloku i dytë i Kosovës B, atëherë vërtet nuk duhet të jesh shumë i mençur për të kuptuar, që muaji janar do të jetë më i vështirë sesa muaji dhjetor. Ne sot në këtë buxhetin e ashtuquajtur zhvillimor, nuk do të kemi asnjë veprim që e trajton nevojën për furnizim, sigurim të furnizimit me energji elektrike. A e di çka do të ndodhë? Ajo që po shihet si tendencë e kësaj Qeverie, ju duhet ta shtrenjtoni rrymën për qytetarët e Kosovës. kërkesën për ta shtrenjtuar rrymën për shtatë për qind, që ka qenë para se të bie blloku i dytë i Kosovës B, tashmë e keni në proces. Kjo tregon më së miri paaftësinë dhe mospërgatitjen e moskompetencën tuaj për ta adresuar këtë çështje.

Ne sot prapë duke qenë opozitë që mbi të gjitha e ka interesin e qytetarëve para vendimeve e veprime ditore politike partiake, ju themi se mbështetjen do ta keni për veprime të drejta që së paku i trajtojnë dy çështje: sigurojnë furnizim me energji për qytetarët e Kosovës dhe nuk lejojnë rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Për gjëra të tjera, absolutisht do të jemi kundër dhe nuk do të keni asnjëherë mbështetje.

**KRYETARI:** Fjalën tash ia japim kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kriza energjetike në të cilën gjendet vendi sot, më së miri shpjegohet me mënyrën sesi filloi kjo seancë sot, pra me një paaftësi totale. Qeveria e Kosovës para disa ditësh nxjerr një vendim në të cilin thotë se duhet të trajtohet në mënyrë urgjente kjo çështje dhe nuk e ka guximin të përdorë të drejtën e vet kushtetuese të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme.

Në të njëjtën kohë, Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes thërret seancë të jashtëzakonshme dhe ne jemi sot këtu një orë para se të mbahet një debat parlamentar për këtë çështje. Po, çka ndodh?

Ftuesi i seancës nuk del t'u sqarojë deputetëve dhe opinionit pse e ka ftuar këtë seancë, po del flet Qeveria për një çështje të cilën nuk e ka thirrur seancën.

Pra, për ta përkthyer në termat çka po ndodhë në sektorin energjetik është kjo. ZRRE-ja, pra të caktuarit e Qeverisë vepronë me direktiva të Qeverisë, po Qeveria fshihet. KEK-u nuk i dërgon në remont termocentralet e veta, sepse tutet që Qeveria del keq në zgjedhje dhe e rrezikon vendin dhe tash jemi në këtë situatë këtu. KOSTT-i nuk i merr veprimet e veta për punët që i ka, sepse Qeveria e instrukton ndryshe. Në fund, kryeministri as nuk vjen këtu të flasë dhe të tregojë se çka po ndodhë.

Pra, çka thotë kryeministri? Thotë keni jetuar në terr imagjativ, pavarësisht që ka pasur energji elektrike, dhe sot po jetoni në dritë pavarësisht se nuk ka energji elektrike. Kjo është thënie utopike e kryeministrit.

Për ta marrë Qeveria, kryeministri i sotëm thoshte se gjithçka ishte terr, edhe pse e nisi qeverisjen në dritë, vazhdoi duke thënë se është terr. E tash kur e ka sjellë vendin në terr, po thotë se gjithçka është dritë. Ky kryeministër dhe kjo Qeveri, thëngjillit i thanë jo, ujit i thanë jo, gazit amerikan i thanë jo, helikave të prodhimit të energjisë elektrike me erë jo, energjisë diellore jo, ndërkohë që këtu del edhe pajton pse.

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem, ta dëgjojmë deputetin.

**ARBEN GASHI:** Ndoshta mund ta zgjidhën problemin e krizës energjetike me importimin e kriminelëve nga Danimarka, për të cilët po thotë se do të marrë 210 milionë euro kompensim financiar. Ndoshta. Ndoshta kjo është ideja gjeniale e kryeministrit. Ndoshta e stabilizon krizën energjetike me ulje të konsumit si rezultat i ikjes së njerëzve nga vendi nga mungesa e shpresës që po e rritë kjo Qeveri. Ndoshta, sepse tashmë po bëhet një vit që është në Qeveri. Nuk mund t'ua lë fajin të tjerëve.

Për më tepër, nga objektivi për kthimin e trurit, është ky që po ikin si kurrë më parë. Ndoshta vazhdojmë ta çudisim edhe botën për rritjen e jashtëzakonshme ekonomike përballë krizës më të madhe energjetike. Ndoshta edhe këtë punë e bën ky kryeministër. Ndoshta, fajtorë për këtë krizë energjetike janë edhe sindikatat, si çdo qytetar i vendit që e bën fajtor kryeministri kur punët nuk i shkojnë mbarë e qe besa i thotë që rrymën po e përdor për komoditet. Pra, kjo është e papranueshme dhe e pakuptueshme.

Në emër të shkapjes, i ka kapur të gjitha, duke kapur kështu edhe sektorin e energjisë në fjalë, tash e ka kapur veten për fyti dhe vendi është në terr, sepse kryeministri e ka kapur veten për fyti. Zgjidhjet e nevojshme kjo Qeveri i ka tepër të thjeshta. Për të zgjidhur një problem, i prodhon edhe dhjetë të tjera, d.m.th. se një u zgjidh.

Ndoshta ne nuk po e kuptojmë kryeministrin Kurti, kryeministrin e një vendi të vogël, sepse ai ka potencial për zgjidhje të problemeve globale, se me ato merret më shumë. Andaj, fatkeqësia jonë është që as nuk po mund ta rritim Kosovën e rrjedhimisht as të përfitojmë as nga potenciali global i kryeministrit, rreziku i të cilit është terri kosovar.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Ky kryeministër dhe kjo Qeveri gjithçka gjen. Gjithkund gjen fajtorë, por asnjëherë nuk gjen zgjidhje. Kjo Qeveri për t'i ikur përgjegjësisë, instrukttoi ZRRE-në dhe KEK-un që të mos shkojë në remont sipas planifikimeve, kur dihet që gjatë verës energjia elektrike është rreth 20 euro MW. Nuk e lejoji që të shkojë. Dhe, tash KEK-u detyrohet që dhunshëm të shkojë në remont. Dhunshëm të shkojë në remont për shkak të ndërhyrjes së Qeverisë.

Dhe, çmimi i MW orë për energji elektrike ka qenë 510 dollarë. Kosova në mënyrë të padrejtë devijon rreth 5 milionë euro në ditë energji elektrike. Kjo është kriza, ky është rezultati që ka prodhuar ky kryeministër.

Pra, njerëzit e vet që i ka çuar në KEK dëshmojnë paaftësinë e asaj e që u dëshmuar edhe sot këtu, në mënyrën si filloi kjo seancë. Njerëzit e vet që i ka çuar në ZRRE e falimentojnë KEDS-in dhe për pasojë i qesin në rrezik falimentimi shumicën e kompanive në Kosovë. Shumica e kompanive në Kosovë sot janë para falimentimit.

Ato duhet të shohin përdorime alternative të energjisë elektrike, pra, për blerjen e gjeneratorëve me dhjetëra e qindra mijëra euro për të prodhuar energji elektrike dhe për të mbajtur linjat e tyre të prodhimit, përndryshe janë jashtë tregut. Ky është rezultati që ka dhënë kjo Qeveri.

Ky është rezultat, krejt dhe drejt, i kapjes për fyti të shtetit të Kosovës. Ashtu qysh e ka kapur për fyti sektorin e energjisë elektrike, i cili po pëlçet sot, ashtu po e kap për fyti sektorin e drejtësisë, sektorin e arsimit, të shëndetësisë dhe cilin sektor veç e veç.

Ky është rezultati që kryeministri i këtij vendi, kur ishte kandidat thoshte se është terr dhe ne do t'ua bëjmë dritë dhe tash thotë, ishte terr dhe u bë dritë, ndërkohë që Kosova është në terr energjetik dhe njerëzit po ikin prej këtij vendi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën ministres tash. Ministrja Rizvanolli e ka fjalën.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Ju faleminderit për diskutimet tuaja!

Po kërkoj falje paraprakisht që fjala ime nuk do të jetë aq e strukturuar për faktin që kritikën tuaj janë shumë kontradiktore dhe nuk po di në cilën të përgjigjem edhe qysh.

Njëri thotë, efektet e vendimit që i keni marrë nuk po shihen në terren, tjetri thotë, po i legjitimoni ato që veç i keni marrë. Njëri thotë, ZRRE-ja po e falimenton KEDS-in, tjetri thotë, pse po i subvencioni, tjetri thotë, shumë mirë që po i subvencioni, është dashur të subvencionohen moti. Domethënë, nuk po di kah të filloj, por megjithatë po provoj.

U përmendet disa dhe thatë, presion politik në KEK. Unë nuk di as si ta komentoj, veç nuk po e komentoj hiç, veç po them se nëse mendoni që kryeministri ose ministrja ose dikush tjetër ka shkuar dhe i ka thënë KEK-ut hyn në remont në këtë muaj ose mos hy në remont në këtë ditë, qoftë në Kosovën A, verës që u përmend, qoftë në Kosovën B, tash, atëherë veç mund të them që kjo nuk është e vërtetë.

Pse ka eksportuar KEK-u gjatë verës, dhe pse s'është planifikuar energjia më mirë? Nuk e kemi pasur mundësinë që ta bëjmë një bllok verës e t'i bëjmë gjashtë blloqe dimrit. Kapacitetet janë fikse. Verës kemi prodhuar më shumë sesa që kemi pasur, dimrit kemi më pak. Kjo dihet, kjo gjithnjë ka qenë kështu edhe do të vazhdojë që të jetë kështu, përderisa nuk kemi kapacitete të tjera që ta mbulojmë edhe dimrit.

Sikur të ishte liberalizimi i tregut që e keni parandaluar, sot do të ishte një situatë krejt tjetër. Situatë krejt tjetër është vërtetë do të ishte, se 80 firma do t'i kishe pasur në treg të liberalizuar, të cilat do të duhej ta paguanin rrymën deri 500 euro për MW orë, është e vërtetë. Nuk besoj që do të na ndihmonte kjo.

Shtetet tjera çka janë duke bërë që e kanë tregun e liberalizuar, është duke vendosur çmime në tavan, ne i kemi këto për shumicën dërmuese të konsumatorëve edhe shtëpiak edhe të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Shteti nuk ka blerë energji me kohë. Këtu së pari më duhet t'jua sqaroj që shteti nuk blen energji, janë furnizuesit ata të cilët blejnë energji. E dyta, nuk është forward market-futures market. E treta, ma tregoni një vend, nëse veç e keni këtë kritikë për KESCO-n, që nuk ka blerë energji më herët. Pra, ju ftoj të ma tregoni një vend në Evropë ose kudo tjetër që në këtë mënyrë e ka tejkaluar krizën dhe është duke kaluar mirë. Ma tregoni një vend që është duke kaluar mirë. Dhe e dyta, po e përsëris edhe një herë, shteti nuk blen energji.

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem! Ministra iu dëgjoj të gjithëve, tash ju duhet ta dëgjoni atë.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Shtetet tjera... Mund ta shikoni Ligjin për energji ose Ligjin për energji elektrike, këto gjëra dihen. E keni një KESCO, a ju shet Qeveria energji.

Gjendja emergjente në rajon është shpallur më herët. Shtet e tjera e kanë shpallur gjendjen më herët, sepse janë prekur nga kriza më herët. Shqipëria nuk është ekspozuar nga importi më herët.

Kriza nuk ka lindur në Kosovë, e ka prekur Kosovën e fundit, për arsye se deri vonë ne kemi arritur që konsumin tonë ta mbulojmë me kapacitete vendore.

Nuk kemi mundur ne ta shpallim krizën para tre muajsh, edhe do të mundnim, por asgjë s' do të bënim me atë punë. Sepse, në atë kohë kemi qenë duke e mbuluar konsumin tonë me prodhimin tonë.

Jemi prekur nga mesi i tetorit. Më 2 nëntor e kam themeluar task-forcën për menaxhimin e krizës, e cila i ka bërë parashikimet, mirëpo këto parashikime, këto dëme janë tejkaluar shumë, për shkak se në ndërkohë çmimi është rritur shumë dhe ndërkohë kemi pasur rënie të blloqeve, së pari të tri blloqeve të A-së, e pastaj të një blloku të B-së.

Sa u përket blloqeve, një herë kishte ankesë që KEK-u nuk ka punuar mjaftueshëm që t'i ketë të gjitha blloqet në funksion, pastaj kishte ankesë pse po punon KEK-u me tri blloqe të A-së, gjë që nuk ka ndodhur më herët. Edhe kjo është totalisht e pakuptimtë. Domethënë, KEK-u ka qenë i përgatitur që me 5 blloqe të punojë, për dallim që normalisht që punon me katër blloqe, mirëpo ka pasur defekte të paparashikuara.

Tarifat u përmendën, edhe këtu po jua përkujtoj se, gjithashtu u tha, ZRRE-ja e caktuar prej Qeverisë dhe vepron nën direktiva të Qeverisë. Po jua përkujtoj që ky Kuvend e ka votuar ZRRE-në dhe ZRRE-ja i raporton Kuvendin, e jo Qeverisë.

U fol për tarifa që Qeveria po do t'i rrisë tarifat. Pra, po ju informoj që vendosja e tarifave është kompetencë e ZRRE-së, jo e jona. Nuk keni ndërmarrë asgjë për grupet e rrezikuara. Nuk ka pasur rritje të tarifave që të ndryshohet diçka, nga ana tjetër janë dhënë 4.5 milionë euro për përfituesit e ndihmës sociale.

Nuk keni komunikim me Republikën e Shqipërisë, e cila ka mjaftueshëm energji. Nuk është e saktë. E ka thënë disa herë edhe në Kuvend edhe në komision, edhe në media që kemi pasur dhe kemi bashkëpunim dhe komunikim në baza ditore me Republikën e Shqipërisë.

Para disa ditësh Republika e Shqipërisë ka qenë vet duke shkaktuar devijime, për arsye se s'ka pasur mundësi që t'i mbulojë kërkesat e veta. Dhe, ne do të vazhdojmë komunikimin dhe bashkëpunimin me ta, në mënyrë që të sigurohemi që momentin që ata kanë mundësi, të bëjmë këmbimin e energjisë për të cilën flisni.

Cili është efekti i 20 milionëve që janë dhënë, cili është efekti juridik e të tjera? Nëse i shihni këto drita lartë këtu, efekti i atyre 20 milionëve, janë këto. Në momentin që kanë filluar të shpenzohen 1 milion, janë ndalur reduktimet ose së paku janë ndalur reduktimet në masë të madhe. Dhe, këto janë që po i shihni. Nuk e keni parandaluar krizën...

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: A deshët ta parandaloni krizën botërore, a deshët që të ndërtojme ne kapacitete të reja për tetë muaj apo deshët të subvencionet apo të mos subvencionohet, se subvencionin e kemi dhënë.

Përveç kësaj edhe KOSTT-it ia kemi kthyer dividendën të cilën ata do ta përdorin për ta tejkaluar situatën me likuiditet. Me kaq do ta mbyllja një herë.

KRYETARI: Së pari ia japim një replikë lidhur me këtë që e tha ministrja, deputetit Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Ministrja e nisi shumë mirë fjalën e vet, tha, nuk po di si të përgjigjem, po provoj. Realisht, ti edhe detyrën e ministres nuk po di si ta bësh, veç je duke provuar, njëjtë sikurse shumica e kësaj Qeveria.

Nuk e keni idenë se cila është detyra dhe përgjegjësia jote, s'je duke e kuptuar as thelbin e problemit, por je duke e provuar. Por, përderisa ti po provon ta kryesh punën tënde, njerëzit janë në të ftohtë dhe janë në terr. Këto 20 milionë na paskan siguruar neve dritat.

Çfarë mund t'u thuash njerëzve në Kroin e Vitakut që tri që s'kanë rrymë? A është ndalur restriksioni atje? Çka mund t'u thuash njerëzve anembanë Kosovës që kanë deri në 12 orë restriksione, edhe dje edhe pardje? Kë po e mashtroni? A jeni duke e mashtruar veten, a je duke e mashtruar kryeministrin, a je duke na mashtruar neve, a je duke i mashtruar qytetarët të cilët janë të mërdhirë dhe në terr? Lërimi këto gjëra, po shikoni dhe koncentrohuni në punë.

Mua më vjen keq me nivelin e papërgjegjesisë dhe të padijenisë që e keni. Po thua, ma gjeni një shtet në Evropë. Po, qe po ta gjejmë, Malta. As nuk ka krizë energjetike, as nuk janë rritur çmimet. A di pse? Sepse i ka caktuar kontratat për ato që ju flasim që sa herë, në fund të vitit të kaluar.

Dhe, a di se çfarë vendimi ka marrë Qeveria e Maltës, po ashtu shtet i BE-së, që as në vitin 2022 nuk do të ketë ngjitje të tarifave të energjisë për qytetarët e atij shteti. Pse? Se kanë Qeveri të përgjegjshme që ka marrë vendime të duhura në kohën e dukur.

Po thoni, s'na ka prekur kriza deri në fund. Ju a jeni zjarrfikës apo çfarë jeni? Domethënë, veç kur të del zjarri, ju e nxirrni ujin që ta ndalni zjarrin. Nuk jeni ju për ta përgatitur, të keni plane, të keni planifikime të mëhershme.

Dhe shikoni, ju duhet të na bëni të qartë se a jeni pro rritjes së çmimit të energjisë apo jeni kundër. Arsyetimi se ju s'e rrisni energjinë, po e rrit ZRRE-ja, është miratimi që ju po ua bëni që t'iu rritet çmimi i rrymës për qytetarët e Kosovës.

Ti personalisht edhe kryeministri duhet të dilni dhe deklaroni se a jeni pro rritjes të çmimit të energjisë apo jeni kundër. Tregoni drejtë.

KRYETARI: Një replikë, po ashtu, deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht, javën e kaluar unë kam kërkuar në mënyrën më të butë institucionale që një pjesë e Kabinetit qeverisës duhet të ikë, e veçanërisht ata që merren me sektorin e energjisë.

Sot, po plotësoj, po them, ndoshta pak më shumë se gjysma e Kabinetit, sepse sinqerisht të dëgjosh duke thënë që, shteti as nuk blen rrymë as nuk shet rrymë. Kush është shteti? Sa për dijeni të pjesës së caktuar të Kabinetit të Qeverisë. Sektori i energjisë në të gjitha levat e saj, menaxhohet nga shteti, dhe shteti është aksionar 100%, i raporton Qeverisë edhe KEK-u edhe ZRRE-ja, përjashto shërbimet. Po flasim për resurset e sektorit. Se po i shoh që tash iu ra ndërmend se çfarë është shteti.

Resurset i menaxhon shteti, rregullatorët i ka shteti, buxhetin e miraton shteti, kuadrot i zgjedh shteti, dhe një Qeveri, një ministër, që del dhe thotë, shteti nuk blen. Po ti bleve rrymë, ia dhe KEK-ut 20 milionë dhe i the blej rrymë. A je shtet. Kush është shteti këtu? Kush i cakton bordet? Kush i cakton rregullatorët? Kush jemi ne këtu që i zgjedhim rregullatorët?

Pra, për cilin shtet po flisni? Unë kam menduar që bile për shtetin jeni pak më të konsoliduar. Realisht, ju as konceptet bazë të shtetit dhe lerë më këto të tjerat, nuk po na i thoni.

Urgjentisht nëse doni ta shpëtoni shtetin, të largohen ata që janë të involvuar në sektorin energjisë me paaftësinë e tyre që po e tregojnë tash e nëntë muaj ditë. Nëse e doni shtetin!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri i Financave, Hekuran Murati.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lidhur me diskutimet që po bëhen këtu, unë po besoj që debati për energjinë do të duhej të ishte më vonë. Pra, këtu kemi një pikë të rendit të ditës, mirëpo vetëm për t'i adresuar disa prej të pavërtetave që u shtruan në këtë Kuvend.

Është çështja e të pavërtetave edhe të mosdijes besa, që po shprehet në mënyrë eklatante këtu nga disa folës. Po thuhet që është dashur të blihet energji. Siç e sqaroi ministrja edhe njëherë po jua sqaroj, i nderuar deputet Shala! Furnizuesi, licencën e furnizuesit e ka KESCO, të cilin ju e keni shitur.

Sepse, kur e keni shitur keni thënë që këta menaxhojmë më mirë, apo jo? A keni thënë që këta e menaxhojnë më mirë, sepse janë privat. Tash, privati me licencën që e ka është dashur që të përkujdeset edhe për blerje të energjisë.

Sa i përket blerjes së energjisë dhe të sigurimit të çmimeve më të favorshme ose më pak të favorshme. Unë dyshoj që ndonjëri këtu e ka ekspertizën e nevojshme që të na tregojë përtej dijes anekdotale, sa i përket se si funksion bursa dhe çmimet energjetike dhe kontratat futures jo forwards. Domethënë futures contracts, çdoherë e ke çmimin më të lartë, sidomos për sezonin dimëror, sepse bëhet fjalë për spekulim. Bëhet fjalë për spekulim.

A e dini zoti Krasniqi, a e dini sa është çmimi futures për janar dhe për shkurt? A e dini? Ju lutem, të na tregoni, pastaj flasim!

Çështja tjetër është, u tha që janë kthyer reduktimet. Reduktime ka pasur vit pas viti. Për deputetin Abdixhiku që tha reduktime, mund të jetë ndoshta i ri në Kuvend edhe në subjektin LDK, por ka qenë pikërisht deputeti nga LDK, kryesues i Komisionit Hetimor Parlamentar për reduktimet e energjisë elektrike, deputeti Muhamet Mustafa nëse s'gaboj, që ka bërë komisionin hetimor për këtë çështje dhe ka ardhur në përfundimin që ka pasur reduktime të paligjshme nga ana e operatorit, ka pasur reduktime të paligjshme. Domethënë, është raport i Komisionit Hetimor Parlamentar.

Reduktime ka pasur çdo vit, vetëm se dallimi ka qenë atëherë nuk ka qenë Lëvizja Vetëvendosje në Qeveri dhe nuk është sulmuar Qeveria, e para. Dhe, e dyta, reduktimet kryesisht janë bërë në zona rurale për të cilat nuk është se janë brengosur fort deputetët e Kuvendit ndoshta, apo politikanët që i kemi sot në opozitë.

Kurse sot, meqenëse reduktimet janë bërë ditëve që patëm edhe në Prishtinë, ka një ankesë më të madhe. Megjithatë, falë intervenimit tash kemi një stabilizim të situatës energjetike.

Çështja tjetër. Po thuhet që shtetet tjera po e menaxhojnë më mirë. Shtete si Franca po importojnë qindra-miliona në ditë, import nga Gjermania dhe Belgjika. Po, po, por megjithatë, nëse po flasim për menaxhim dhe një shtet si Franca paska përfunduar duke i importuar qindra-milione euro në ditë, për çfarë menaxhimi dhe planifikimi më të mirë jemi duke folur.



Kjo nuk është çështje e menaxhimit të një Qeverie, kjo është çështje një krize jashtë kontrollit të çdo qeverie.

KRYETARI: Qetësi, deputetë, ju lutem!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Po përmenden edhe vendet e rajonit si shembull. Shqipëria deri më tash ka importuar 200 milionë euro, dhe prej 1 janarit bizneset do të kalojnë në tarifën, pra në tregun e liberalizuar që po kërkon deputeti Shala, me çmimin prej 30 centë për KW orë, 30 centë.

Ju po thoni, bëni si Shqipëria, mirëpo të mos e rrisni çmimin, e në Shqipëri çmimi do të bëhet 30 centë, do të trefishohet për bizneset. Në Maqedoni njësoj, çmimi do të rritet për herën e dytë brenda një viti. Në fillim të këtij viti është rritur njëherë, dhe këtë vit pritet që të rritet përsëri. Sipas rregullatorit, pritet që të ketë rritje përsëri të çmimit në Maqedoninë e Veriut.

Pra, në njërën anë po na thoni që shikoni këto vende sa mirë po e menaxhojnë, mirëpo ato kanë rritje të çmimit, e në anën tjetër po thoni, menaxhoni si ata, por të mos e rrisni çmimin. Këtu kemi një paradoks dhe një kundërthënie logjike.

Pra, këtu ose nuk po e dini për çka jeni duke folur dhe nuk e kuptoni se si funksion tregu energjetik ose vetëm jeni duke tentuar që të manipuloni opinionin siç edhe e bëni tash e sa kohë për shkak se jeni në opozitë. Faleminderit!

KRYETARI: Dy replika i kemi për fjalën e ministrit. Së pari po ia japim fjalën zotit Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Me të vërtetë jam i dëshpëruar me faktin e mungesës bazike të njohurive të ministrit të Financave. Forward markets dhe future markets janë dy gjëra të ndryshme, zoti Murati, është përnjëmend e dhimbshme, ti je ministër i Financave, këto punë duhet t'i dish. Më duket ke studiuar ekonomi, a po kupton. Jo, jo, Forward market, më fal që nuk e kam terminologjinë në gjuhën shqipe, ti ke studiuar pak edhe anglisht, po më duket, duhesh të kuptosh, ka dallim esencial. Forward është kur merren vesh jashtë bursës dy palë drejtpërdrejt, qysh ndodh shumica e furnizimit me energji me kontrata të fiksuara në Evropë. Future market është brenda exchange ose bursës. Qysh është e mundur ti, si ministër, të mos i dish këto punë, këtu është dallim esencial, këto studentët e vitit të tretë në ekonomi kur nuk i dinë duhet rrëzuar prej provimit.

Ministrja e Energjisë nuk di për çka është duke folur për energjinë, ministri i Financave s' di për sendet bazike në financa, unë me të vërtetë nuk e di çka t'ju them më shumë. S'ia vlen as të flitet me juve!

KRYETARI: Kundër-replikë, ministri Murati!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Komplexet e mosdijes s'mund t'i pasqyroni tek unë. Nëse thoni që Forward Contract bëhet mes dy palëve, jashtë tregut, s'mund të thuash Forward Market. Domethënë, kur vetë e the, bëhet jashtë tregut, jashtë bursës bëhet, është koncept bazik, zoti Krasniqi. Këto punë nuk mësohen duke shikuar video në You Tube.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem! Te dëgjojmë argumentin e ministrit, edhe një replikë e ka deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Unë nuk po e kuptoj a është demagogji e porositur, apo huqje e ministrit kur thotë që KEK, KESCO dhe të tjerët kanë të drejtë të marrë energji pa e pyetur shtetin. Kjo është huqje e madhe.

Nuk mund të blejë kush energji pa e miratuar Zyra e Rregullatorit të Energjisë, sot e patëm në komision. është me ligj e rregulluar, e di mirë kënd e ke dërguar aty. Pikërisht ti e di, prandaj mos bë këso manipulime publike, sepse blerjet, qoftë në procedurë të rregullt, qoftë të jashtëzakonshme, prapë në çfarëdo forme Rregullatori që ne e kemi zgjedhur i miraton, pra shteti, Rregullatori dhe gabime të tilla me ose pa dije tënde na bëjnë diçka që sinjerisht është huqje e madhe. Ai mund ta zgjedhë tregun brenda e jashtë, por limitet i përcakton Rregullatori, sasinë e përcakton Rregullatori, ai nuk ndërhyt në ndonjë orientim tjetër që mund të jetë i prejudikuar, por këto janë huqje të mëdha. Ministër, dije që po të jetë këtu të blejë dhe të shesë kush të do, ishte krejt diçka tjetër. Pikërisht Rregullatori ato që ju sapo i ngritët e ka dënuar një operator të brendshëm me shuma të caktuara që i përmendët më herët, kontratat, pikërisht për shkak të lëshimeve që janë bërë, po supozojmë që po i besojmë dhe duhet besuar.

Pra, ka një Rregullator, nuk është ky treg kush çka të dojë të bëjë, qysh po e mendoni kështu shtetin ju. Pra, mos manipuloni, sepse Rregullatori e di saktë kush blen, sa blen, kur blen dhe pse blen, dhe i miraton tarifat, i miraton sasinë, i miraton shumë gjëra të tjera. Është total keqinterpretim me ose pa dashje apo vetëm të mbulohet termi kohor. Për atë e kemi krijuar shtetin, nuk e kemi zbuluar ne sot pse keni ardhur ju...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti i Vetëvendosjes, Jahja Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,  
Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,  
Zonja dhe zotërinj,

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem! Deputetë, ta dëgjojmë zotin Kokaj, ju lutem!

**JAHJA KOKAJ:** Kam respekt të veçantë për të gjithë kolegët e opozitës, sikurse edhe të pozitës, por nganjëherë kur flasim për termat, duke përdorur terma teknikë në mënyrë të gabuar po kam drojë që po e zbehin atë për të cilën po flasim.

Me shumë respekt për një koleg të Demokratikes, por që kam respekt të veçantë për atë personalitet, por ajo prishja, ajo avaria që ka ndodhur ka karakter tekniko-teknologjik, edhe ai e di shumë mirë, besoj, por që identifikimi edhe rregullimi është problem për të cilin nuk është ashtu siç ai e thotë. Në qoftë se ka nevojë, unë mund të debatoj edhe ta elaboroj. Kurse, sa i përket magazinimit të energjisë, përkatësisht akumulimit, është problem serioz. Krahas prodhimit të energjisë, vjen edhe magazinimi, përkatësisht akumulimi. Vetëm vitin e kaluar është bërë një zbulim të nivelit Nobel, me të cilin pastaj magazinimi do të jetë i ri, por fatkeqësisht prej zbulimit deri te aplikimi kalojnë 5-6 vjet.

Por, unë nuk dola të flas për këtë, dola të flas për problemin në tërësi dhe problemi në tërësi ma merr mendja për problemin për të cilin flasim, për energjinë, duhet ta fillojmë me faktin që ne jemi vend i bekuar nga Zoti që faktikisht jemi vendi i tretë për nga potencialet energjetike thëngjillore. Fatkeqësisht, ato nuk i zbatojmë dhe në qoftë se flasim deri nesër, ne nuk mund ta zgjidhim pa e ditur se ku jemi ne, ku jemi sot. Sot, pas 50 vjetëve, pas një gjysmë shekulli të universitetit, Akademisë së Shkencave, pas qindra doktoratave, ne të strukur në dhoma të ftohta presim një gjerman të vijë e të na e rregullojë gjeneratorin. Kjo është e vërteta, zotëri i nderuar, kjo është e vërteta e pamohueshme. Dhe, tani e pyesim pse pikërisht ka ndodhur kjo situatë, edhe atij duhet t'i paguajmë 25 mijë euro, e tjera, e tjera, me çdo respekt, se ai e meriton. Por, duhet të pyesim tani çfarë shkoi mbrapsht? Cila është arsyeja? Arsyen duhet ta nisim me faktin sidomos 20 vjetët e fundit, pa dashur të kritikoj askënd, por ta shikojmë realitetin sy më sy, të vërtetën sy më sy, që posa erdhëm neve në liri, atëherë ata teknikët, inxhinierët që ishin kompetentë i larguam, disa prej tyre kanë vdekur, njërin për të cilin do të flas menjëherë, por disa të tjerë akoma janë të gjallë, por askush s'i thërret sot të bisedojmë.

Pastaj, aty ishte edhe një bërthamë shkencore, të cilin e udhëhiqte akademik Alajdin Abazi, një bërthamë shkencore, me të cilin kam marrë pjesë vazhdimisht edhe unë. Ajo bërthamë shkencore u anulua fare. Bërthama dhe mendimi shkencor udhëheq teknologjinë, kjo s'është tani. Do të thotë, është anuluar teknologjia, është nulifikuar mendimi shkencor dhe punohet ad hoc. Pastaj, një pyetje tjetër kam për t'ua bërë të gjithëve, pozitë e opozitë, kolegëve të mi të nderuar. Sa ministra, cilët ishin ata kompetentë të cilët ishin në vendin e duhur, në momentin e duhur? Cili ishte profesioni i ministrave dhe sektorë të caktuar, profesioni i tyre dhe sa ata punonin me

kompetencë? Ata punonin me kompetencë, sipas mendimit tim, për t'i punësuar militantët e vetë, ilaket e veta, e tjerë, e tjerë.

Por, qëllimi i paanshëm është qëndrimi shkencor dhe duke parë këtë, jua kam treguar këtë libër që ka dalë nga Albshkenca, është fjala për një tubim shkencor në vitin 2006, ku Albshkenca organizoi pikërisht për problemet dhe konferenca ndërkombëtare për monitorimin e ndotjeve dhe zhvillimeve energjetike në Kosovë dhe Shqipëri. Aty erdhën njerëzit më kompetentë të Kosovës, më kompetentë të Shqipërisë, mendimtarë shkencëtarë të globit tokësor, edhe disa të tjerë joshqiptarë dhe morëm me grupe të caktuara, në formë edhe të workshopit, morëm qëndrime të caktuara pas një debati njëjavor. Po e përmend, ka pasur kështu udhëheqës të seksioneve të caktuara, po e përmendi njërin, Avni Kurshumliun. Avni Kurshumliu e kam pasur shok të klasës, po tani ka vdekur, por mesazhi i tij është i gjallë. Po të realizohej, të aplikohet mesazhi i tij, nuk do të kishim këtë problem, para të cilit gjendemi. Mesazhi i tij ishte shumë i qartë: njeriu i cili punoi për gati katër dekada në Obiliq, njeri me kompetencë shumë të madhe, pati thënë menjëherë pasluftës që pjesë të Kosovës A të anulohen, ato teknologji të vjetra dhe të aftësohen me teknologji, të arnohen me teknologji bashkëkohore dhe filtruese pjesët e mbetura dhe të aftësohen tërësisht pjesa e Kosovës B.

Për më tepër, ai propozoi që në Kosovën B të shtohet edhe një bllok, i cili do të prodhonte 630 Megawat, për prodhimin e të cilit duhet të investonim në mënyrë vetjake, duhet të investonim në mënyrë vetjake në bashkëpunim me Shqipërinë, pra në mënyrë simbiotike dhe se verës që ne ta furnizojmë Shqipërinë në mënyrë huazuese, kurse dimrit të na e rikthejë, pra të bëhet një simbiozë energjetike, e cila s'ndodhi kurrë në atë mënyrë. Fatkeqësisht, Avniu u marginalizua, sikurse edhe mendimtarë të tjerë, po ai planifikonte që në vitin 2023 të mbyllet edhe Kosova A edhe Kosova B, ngase mendonte që duhet të ndërtohej një termocentral tërësisht i ri, i cili do të ishte me filtra adekuatë, pa ndotje, pra me ndotje tejet minimale dhe i cili do të ishte shumë i vlefshëm dhe ne do të kishim energji për të shitur.

Ne kemi potencialin e tretë në botë, prandaj sikurse Kuvajti që është i treti për nga potencialet e naftës, ashtu edhe ne duhet të ishim të pasur sot për kokë banori apo bruto prodhimin vendor. Këtë s'e kemi bërë, këtë duhet ta bëjmë. Po e përmend edhe një autor të asaj konference, profesorin Ardian Morina, profesor i Lids University United Kingdom, i cili fliste për lidhmërinë e raporteve, për raportet e potencialeve njerëzore dhe energjetike. Ai fliste pikërisht për këto që flisni ju tani, për distribucionin, për prodhimin, shpenzimin, për përndarjen, e tjera, për të cilat nuk do të hyj në detaje. Dhe, në fund ishte edhe një propozim imi, që kam dëshirë me modesti ta them, por që mund ta shihni në internet, disa rezultate të mia shkencore për energjinë fotovoltaike, ku me grupin tim pata prodhuar një efikasitet në atë botë 26%, më vonë arrihet 38%, sot e kemi efikasitetin e ardhshme deri në 71.4%.

Në qoftë se arrijmë 85% eficiencën e energjisë voltaike, atëherë tërësisht neve e bëjmë energjinë totalisht të lirë, pothuajse gratis dhe e bëjmë gjithmonë të pranishme. Kjo arrihet me zhvillimin e një shkence që do të jetë revolucionare, ajo quhet Nanoteknologji. Unë do të jem këtu para jush për të ulëritur, do të vazhdoj edhe në të ardhmen të ulërij kështu që të avancojmë zhvillimin shkencor, të kultivojmë nanoteknologjinë, të kultivojmë energjinë për së mbari, por në mënyrë shkencore, me parametra shkencorë dhe duke shfrytëzuar potencialet mendore e shkencore, të cilat i kemi brenda dhe jashtë vendit. Prandaj, kur është fjala për energjinë, për problemet teknike, teknologjike, t'i lëmë anash përkatësitë politike, për arsye se duken shpeshherë edhe qesharake, të flasim vëllazërisht për problemet, të cilat janë shumë serioze, por për ato duhet të flasim dhe duhet të jenë vendimmarrës njerëzit me kompetencë profesionale dhe shkencore.

Njerëzit pa kompetencë, tash unë s'jam...

**KRYETARI:** Kryetarë të grupeve, a mund ta kemi qetësinë, ju lutem, se po flet deputeti!

**JAHJA KOKAJ:** Tash, unë s'jam kompetent të flas për problemet juridike, ekonomike, e tjerë, por për problemet e energjisë, për problemet e përndarjes, e bartjes, e tjera, unë e shoh që po flasim njerëzit pa kompetencë, prandaj ju thërras që të mendojmë për zhvillimin shkencor, të stabilizojmë universitetin, t'i kthejmë bërthamat shkencore, ashtu siç ishte, për shembull, në Fabrikën e Amortizatorëve, ku isha pjesë e asaj bërthame, po ashtu. Bërthamat shkencore i kishim në në plan, gjithmonë në atë botë lidhmërinë e industrisë me shkencën, duke e shfrytëzuar dhe ekzistencën e bashkësisë shkencore investuese për shkencë në Kosovë.

Ne 20 vjetët e fundit investimet në shkencë, e në mendim, në ardhmëri të kombit në këtë aspekt janë zero. Prandaj,...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Tash, fjalën nga PDK-ja e ka deputeti Xhavit Haliti.

**XHAVIT HALITI:** Faleminderit, kryetar! Unë nuk jam specialist i energjisë, por e di që historikisht kemi pasur probleme me rrymën në Kosovë, jam dakord me ato që thanë parafolësit e mi, kryesisht me ato që tha Ferati që është dashur planifikimi.

Faji, tendencat janë të mbetet jetim, por po besoj që ka pasur mundësi planifikimi dhe të blihet paraprakisht, nuk e di a ka pasur fond qeveria a jo, cilat kanë qenë mundësitë financiare të Qeverisë dhe a ka pasur kontakt me kompanitë relevante që shesin energjinë elektrike. Unë mendoj që kjo është për neve me interes që të informohemi dhe, në qoftë se Qeveria nuk ka dashur ose nuk ka pasur raporte të ndërtuara me ata që është dashur, qysh po thoni, me KEDS-in, ose kush është kompetentë për të blerë. Ndoshta s'kanë pasur para të blejnë energjinë elektrike

dhe interesi ynë si deputetë, ashtu siç është edhe i opinionit të dijë ku është defekti kryesor. A kemi pasur mundësi apo s'kemi pasur ta blejmë dhe si të dalim prej kësaj situatë? Unë po e kuptoj shumë mirë që nëse Qeveria i jep 200 milionë sot për të blerë energji elektrike, ato janë paret e buxhetit të Kosovës. Me siguri që duhet rritur çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët dhe prapë do të kemi debate në Parlament dhe do të kemi debate edhe me qytetarët e Kosovës, të cilët me siguri që do të kenë problem ta paguajnë energjinë elektrike.

A do të ketë Qeveria mundësinë që t'u ndihmojë të paktën një kategori që s'kanë as fuqi financiare për ta paguar energjinë, janë defekte që s'kanë lindur sot, defekte që kanë qenë të kapaciteteve tona prodhuese të energjisë, por këto defekte janë sanuar me politika, të cilat kanë planifikuar kur duhet blerë, sa duhet blerë dhe nuk kemi pasur restriksione të tilla. Jam plotësisht dakord me zotin Kokaj, i cili e tha një të vërtetë, është e papranueshme që Kosova të mos ketë specialistë që mund ta sanojnë një gabim ose një diçka që ka ndodhur atje në Kosovën A ose Kosovën B, se s'po jam i sigurt, ku është dhe cili është gabimi tash. Por, ne kemi thënë që kemi universitete, tani kemi bërë plot universitete, kemi kapacitete intelektuale dhe nuk e kemi pasur veç në këto 20 vjet këtë termocentralin, por që nga Kosova B kur është hapur e reja dhe ajo e vjetra Kosova A, ne kemi thënë që kemi kapacitete të mjaftueshme teknike, teknologjike, kanë studiuar për elektroteknikë, për teknologji, për gjithçka ka pasur këtu në Kosovë studentë, profesorë të universitetit dhe vërtet për një sanim të gabimeve ose të metave në një agregat apo gjenerator, të paguhet një kompani gjermane, më duket e panevojshme.

Por, sidoqoftë, anën teknologjike domosdo që duhet ta blejmë nga gjermanët, më mirë se diku tjetër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Diskutimi së bashku me propozuesin e debatit të ardhshëm, këta katër deputetë që kanë mbetur për diskutim, nëse pajtohen që të kalojë në atë pjesën tjetër, mirë, me mirëkuptimin tuaj. Nëse jo, atëherë po ju paralajmëroj prej tash që nëse flisni të gjithë, detyrohemi të marrim pushim, e pastaj debatit të AAK-së t'i kthehemi tek më vonë, kah ora 15:00, për shembull.

Nëse doni ta hapim debatin për energji dhe është e njëjta temë faktikisht, përveç nëse doni të flisni dikush enkas për vendimin që na ka ardhur prej Qeverisë, po deri tash nuk dëgjova asgjë të tillë. Nëse deputetët e ardhshëm e kanë në diskutimet e tyre atë fokus, atëherë vazhdojmë, por pastaj detyrohemi të marrim pushim e kthehemi në orën 15:00 pastaj. Mirë! Deputetët dëshirojnë të flasin patjetër në këtë pjesë, prandaj fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kemi dëgjuar ankesat e Qeverisë Kurti për sektorin e energjisë dhe unë konsideroj që është legjitime edhe të ankohen për 20 vjetët e kaluara, për qeveritë që kanë qeverisur ndër këto vjet, po asesi nuk është legjitime që këta të befasohen me gjendjen në sektorin e energjisë, duke marrë parasysh se kanë qeverisur pesë muaj edhe në vitin 2020 dhe besoj se është dashur ta skanojnë situatën.

Ju nuk mund të merrni merita sa herë që administrata publike ka sukses për diçka dhe t'i quani të korruptuar ata dhe gjithkënd tjetër që ka qeverisur për 20 vjet, sa herë që të ndodhin kriza, siç është kjo në sektorin e energjisë elektrike. Vendimin që sot e keni sjellë në Kuvend, ju rikujtoj që Maqedonia e ka marrë më 9 nëntor, e Shqipëria e ka marrë më 8 nëntor. Ju e keni neglizhuar situatën. Jeni popullistë dhe keni menduar që problemin e energjisë ta zgjidhni me popullizëm, por më së paku ky problem mund të zgjidhet në një mënyrë të tillë.

Kur jeni në Qeveri, besoj se tashmë jeni bindur, të rastisë të marrësh edhe vendime të vështira dhe jo vetëm vendime të lehta. Është shumë lehtë të marrësh vendim t'u shpërndash fëmijëve të vegjël nga 20 euro shtesa, respektivisht nga 10 euro, por është tepër vështirë të dalësh e t'u thuash qytetarëve që do ta shtrenjojmë ose do ta rritim çmimin e energjisë elektrike.

Është lehtë të dalësh e t'i marrësh meritat për ngritjen e të hyrave tatimore dhe të thuash “meqenëse, ne kemi ardhur në Qeveri, tani edhe bizneset po paguajnë tatim më shumë”, por është shumë më vështirë sot t'u dalësh përpara pikërisht këtyre bizneseve dhe t'u tregosh për zgjidhje konkrete për krizën energjetike.

Unë konsideroj që kanë faj të gjitha qeveritë e kaluara, pjesë e së cilave disa herë kam qenë edhe vetë, sepse nuk e kanë pasur guximin t'i japin rrugë projektit të madh energjetik. Kosova është dashur t'i ketë sot kapacitetet e veta gjeneruese dhe nëse nuk na janë dhënë kredi, është dashur që ne këto kapacitete t'i ndërtojmë me mjetet tona, siç i kemi ndërtuar autostradat me mjetet e Buxhetit të Kosovës, ose me mjete të privatizimit që i kemi shpërndarë gjithandej nëpër projekte kapitale, e sot po të na pyesë dikush se ku janë, ne nuk e dimë.

Por, këto projekte kanë dështuar dhe fajtorë janë qeveritë e kaluara, por pa faj nuk jeni as ju, sepse i keni kundërshtuar që të gjitha. Bile, tani sapo e shikova një video të emisionit Jeta në Kosovë, në shtator të vitit 2019, kur kandidati për kryeministër në atë kohë, kryeministri i tanishëm, Kurti, premton që do të ketë ulje të çmimit të energjisë elektrike dhe thotë se Contour Global nuk do të vijë në shprehje, sepse do të na e shtrenjtonte energjinë elektrike, e ne nuk jemi për shtrenjtim të energjisë elektrike.

Ju e keni kundërshtuar secilin projekt në sektorin e energjisë. U përmend edhe nga deputetët parafolës dhe gjithashtu disa bashkëpartiakë tuaj edhe nga shoqëria civile kanë lobuar shumë

kundër këtyre projekteve. Qeveria gjithashtu ka faj, se i tha ‘jo’ gazit dhe ka faj për të gjitha vonesat që nuk i ka ndërmarrë vendimet për evitimin e krizës energjetike.

Pas nëntë muajve ende nuk e dini se cila është zgjidhja. Tani keni filluar me strategjinë për energjinë, por të mos harrojmë se kjo strategji po hartohet nën presionin kur çmimi ka arritur mbi 500 euro për MW/orë të energjisë elektrike. Për nëntë muaj ju keni ndërruar borde, i keni mbushur me militantë partiakë dhe po del që as nuk janë profesionistë.

Ministre Rizvanolli, ajo që mbetet të na tregoni është pse nuk ka ndodhur remonti i blloqeve që kanë pasur nevojë për remont gjatë verës, atëherë kur në Kosovë ka suficit të energjisë elektrike dhe ky remont nuk ka ndodhur. Tani jemi në remont, siç u tha “të detyrueshëm” dhe po detyrohemi që të importojmë edhe sasinë e energjisë elektrike që KEK-u ia ka premtuar KESKO-s. Tani, KEK-u ka një bord të ri dhe ky bord e ka zgjedhur menaxhmentin e ri. Cila është arsyeja pse blloqet nuk kanë shkuar në remont atëherë, po i kemi në remont tani, edhe sasia e energjisë elektrike, e cila po prodhohet tani, është e pamjaftueshme.

Ju lutem, na tregoni se çfarë masash keni ndërmarrë për letrat që ne kemi informacione se ju kanë dërguar KEK-u, ZRE-ja dhe KOST-i. Gjithashtu letra ju ka dërguar edhe KESKO, duke ju paralajmëruar për krizën energjetike dhe për shpenzimin e rezervave që të gjithë i kanë.

Gjithashtu mendoj që këtu faj ka edhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë, sepse edhe ata kanë punuar me instruksionet tuaja populliste, kur dolën së bashku me ju dhe thanë që nuk do të ketë ngritje të çmimit të energjisë elektrike. Tani, na tregoni se çfarë po ndodh? Ju ndatë 20 milionë euro. Konsideroj që këto mjete ia keni ndarë KEK-ut për të mbuluar atë sasinë e energjisë elektrike që thashë, e keni premtuar, domethënë KEK-u i ka premtuar KESKO-s, edhe pse, sipas prapë sipas informatave që kemi KEK-u është përgjegjës vetëm për furnizimin brenda 24 orëve. Në qoftë se, ata sot për nesër i kanë premtuar 800 KW dhe nesër nuk mund t’i ofrojnë 800, domethënë ajo pjesë duhet të mbulohet nga KEK-u, ndërsa pjesën tjetër e ka obligim KESKO ta furnizojë gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Unë e di që ZRRE-ja ka dështuar edhe në mbikëqyrjen e investimeve që i ka bërë KESKO dhe KEDS-i gjatë kësaj periudhe kohore, por gjithashtu e di që tani aty është një bord i ri, i cili prapë nuk është në gjendje ta kryejë punën e tij, sepse sikur ta kryente, unë konsideroj që ata është dashur ta mbikëqyrin KESKO-n dhe sot KESKO të ketë energji të parakontraktuar.

Më lejoni t’ju them, që prapë në diskutime me ekspertë të energjisë na është thënë që një mundësi ka qenë, që të bëhet një marrëveshje me Shqipërinë dhe për çdo MW/orë energji elektrike që ne e marrim nga Shqipëria gjatë dimrit, ta kompensojmë, për shembull, me dy MW gjatë verës. Ata gjatë dimrit kanë tepricë, për shkak se i kanë komplet kapacitetet e bazuara në hidro dhe ne jemi ata që kemi tepricë dhe ata kanë mungesë gjatë verës, për shkak se ne e kemi



të bazuar në termo. Por, kjo nuk ka ndodhur sepse ju edhe ata i konsideroni opozitë, apo më mirë me thënë, e konsideroni veten si opozita e tyre. Dhe, e keni pasur politikisht të pamundur ndoshta të uleni dhe të bëni marrëveshje të tilla.

Gjithashtu, e kam thënë disa herë që Zyra e Rregullatorit të Energjisë është peng edhe i privatizimit, e kontratës së privatizimit të distribucionit. Ne e dimë që kemi shtatë operatorë, furnizues të energjisë elektrike, të cilët janë të licencuar nga ZRRE-ja, por de facto asnjëri prej tyre nuk është funksional, për shkak se, sipas kontratës së privatizimit, e gjithë energjia elektrike që prodhon KEK-u, fillimisht duhet t'ia ofrojë KESKO-s, e nëse KESKO nuk e do, mandej ajo mund ta hedhë në treg për operatorët e tjerë. Do të thotë, kemi shtatë operatorë që janë të licencuar, por asnjëri prej tyre nuk është funksional, përderisa KESKO e blen MW-in me shtatëdhjetë euro, operatorët e tjerë asnjëherë me këtë çmim nuk gjejnë energji elektrike në treg.

Dhe, këtu, kur fajësoni qeveritë e kaluara për privatizimin e distribucionit, unë besoj shumë që keni të drejtë. Jua bëj me dije se në atë kohë ne kemi qenë në opozitë dhe e kemi kundërshtuar bashkë me ju, por ju kur i fajësoni, duhet t'i fajësoni të gjithë, edhe ata që sot i keni në grupin parlamentar, ose përndryshe, po u bëjmë thirrje atyre që kanë qenë të involvuar në proces, që nëse dëshirojnë të shfajësohen nga ky faj shumë i madh, është shumë lehtë, mund të kalojnë përkohësisht në Vetëvendosje dhe atëherë të gjitha të bëmat u falen.

Edhe një gjë tjetër, që nga vera, ministre, ekspertë evropianë kanë ndezur alarmin për krizën energjetike dhe ju jeni vonuar. E thashë edhe më herët, jeni vonuar dhe po e bini këtë vendim sot, me tre muaj vonesë, e disa shtete i kanë marrë këto vendime shumë më herët. Do të thotë, përgjegjësia juaj është se nuk e keni marrë asnjë hap dhe vendimin që e keni sjellë sot, sikur ta kishit marrë para dy-tre muajsh, unë konsideroj se do të kishim qenë sot në një situatë shumë më të mirë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministres Rizvanolli ia japim fjalën sërish.

**MINISTRJA ARTANË RIZVANOLLI:** Faleminderit!

Posaçërisht deputetëve Haliti dhe deputetes Bajrami, për qasjen e tyre konstruktive. E para, pyetja se a ka mundur të blejë Qeveria, a ka pasur Qeveria kontakte me tregtarët? Ministria, as Qeveria nuk kanë licencë dhe nuk operojnë, nuk kryejnë rolin e furnizuesit.

Siç e tha deputetja Bajrami, janë shtatë furnizues të licencuar në Kosovë, mirëpo efektivisht njëri prej tyre ka monopol, sepse në kontratën e privatizimit është kontrabanduar një nen, i cili i jep të drejtën ekskluzive këtij furnizuesi për të blerë me çmim shumë të lirë gjithë energjinë e KEK-ut. Kjo është arsyeja dhe kjo kontratë është problem edhe për liberalizimin e tregut për të sjellë oferta më të mira për konsumatorët.

Kjo ka qenë një arsye që na ka vështirësuar dhe ngadalësuar edhe zbatimin e veprimit, sepse nuk ka pasur mënyrë tjetër për të arritur deri te subvencionimi i konsumatorëve, përveç përmes një marrëveshjeje në mes të KEK-ut dhe KESKO-s. E KESKO ka vonuar katër ditë, sepse është kushtëzuar që nëse nuk i mbulojmë dhe nëse nuk subvencionohen edhe humbjet e distribucionit për KEDS-in, të mos pranojë që përmes këtij furnizuesi të bëhet subvencionimi i qytetarëve, e në fakt, mundësi tjetër, furnizues tjetër efektivisht nuk kemi, për shkak të kësaj kontrate të privatizimit.

Kjo është një çështje tejet problematike për sektorin dhe kur të vijë puna e operacionalizimit të ALTEX-it, që kaq shumë jemi duke e pritur, kjo përbën një problem serioz për operacionalizim të ALTEX-it dhe është diçka që do të duhej ta trajtojmë në mesin e problemeve të shumta të sektorit të energjisë.

Dua ta qartësoj edhe një herë, u tha: “Pse nuk e keni shpallur krizën më herët, sikur Maqedonia dhe Shqipëria?” Në kohën kur Maqedonia dhe Shqipëria e kanë shpallur krizën, ata është dashur të japin 80 dhe 100 milionë deri në periudhën kur ne e kemi shpallur krizën, ata i kanë kaluar 100 milionë euro dhe 200 milionë dollarë financa, i kanë dhënë për importim, sepse ata kanë qenë të varur nga importi edhe më herët. Ne jemi në një pozitë tjetër, jemi me fat, sepse deri nga mesi i tetorit ne kemi arritur që pothuajse tërë kërkesën vendore ta mbulojmë me anë të kapaciteteve të KEK-ut, që neve na mundëson të mos ndikohemi nga çmimet e importit.

Mirëpo, ne kemi filluar të ndikohemi fillimisht së paku në masë shumë të vogël...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Urdhëroni, ministre!

**MINISTRJA ARTANË RIZVANOLLI:** Pastaj, ndikimi ka filluar të bëhet pak më i madh në fillim të nëntorit. Unë më 2 nëntor e kam themeluar task-forcën për masa emergjente, në raste emergjente, e cila ka bërë një vlerësim për nevojën e subvencionit për tërë periudhën deri në prill, derisa të ngrohet moti dhe pritët që të ulen çmimet e energjisë. Dhe, plani ka qenë që pjesa e mbetur, pjesa e nevojshme të subvencionohet. Çfarë ka ndodhur ndërkohë është se situata është përkeqësuar. Në kohën kur e ka bërë raportin kjo task-forcë, ka qenë para një muaji, fiks. Para një muaji është bërë supozimi me çmim 250 euro për MW/orë, ndërsa në ndërkohë është ngritur deri në madje 500 euro. Që do të thotë, se nevoja për subvencion tani është shumë më e lartë, se sa ka qenë në atë kohë.

Përveç kësaj, kemi qenë të pafat në kuptimin që së pari kemi pasur rënie të tri blloqeve të A-së, në momentin kur është futur blloku i tretë. Edhe një herë po dua ta qartësoj, se KEK-u, se po

thuhet “pse s’ka bërë KEK-u remont, e tjera..”, nuk është fer ta fajësojmë KEK-un, kur KEK-u ka bërë gjithçka që të punohet me pesë blloqe, që nuk ndodh zakonisht.

Ka pasur prishje të paparashikuara në të dy blloqet, njëra është sanuar brenda ditës, tjetra për fat të keq ende nuk është sanuar, por janë duke punuar në këtë aspekt maksimalisht. Thashë, kemi qenë të pafat në kuptim që edhe çmimet e importit kanë vazhduar të rriten, duke qenë se moti është ftohur edhe në vendet e tjera të Evropës dhe është rritur çmimi, nga ana tjetër, ne nuk i kemi pasur kapacitetet në të cilat kemi planifikuar, që i kemi zakonisht për shkak të rënies së të dy blloqeve. Kjo na ka sjellë në një situatë më të keqe sesa që ka qenë e menduar, sesa parashikimi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Një minutë, i fundit, për ministren në këtë pjesë, sepse ka edhe replika. Pastaj, ministrja mund të përgjigjet.

MINISTRJA ARTANË RIZVANOLLI: Bashkëpunimi me Shqipërinë pse nuk ka ndodhur? Shqipëria, në fakt, siç e thashë, ka qenë në situatë më të keqe shumë më herët sesa ne dhe i ka pasur vetëm disa ditë, kur ka arritur ta mbulojë të gjithë konsumin e vet.

Para disa ditësh prapë ka filluar të bëjë devijime edhe Shqipëria dhe ende nuk është për fat të keq në gjendje që të mbulojë tërë konsumin e vet dhe të na ofrojë edhe neve. Mirëpo, bashkëpunimi me Shqipërinë nuk ka asnjë arsye politike pse nuk ndodh, përkundrazi, siç e thashë edhe më herët, jemi në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm, jo vetëm me Republikën e Shqipërisë, por edhe me Republikën e Maqedonisë.

Po e ndal këtu, meqë besoj se do të kem mundësi edhe më vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Dy deputetë kanë kërkuar replika lidhur me fjalën e ministres. Së pari, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministre, dëgjova me shumë vëmendje se çfarë thatë. E thatë se Maqedonia dhe Shqipëria kanë ndarë qindra milionë euro për të evituar krizën. Mirëpo, unë konsideroj se ne kemi qenë në krizë edhe më herët, jo vetëm sot.

Sipas të dhënave që unë personalisht kam nga KOST-i, devijimet që ka bërë KOST-i prej 16 nëntorit kanë arritur shumën 30,8 milionë euro. 30,8 milionë euro janë devijimet. Do të thotë, energji elektrike që nuk është prodhuar në Kosovë, nuk është importuar nga KESKO, për shkak të çmimit të lartë dhe, meqenëse KOST-i e ka për detyrë të bëjë balance, i ka tërhequr këto nga

interkoneksioni evropian. Si rezultat i kësaj kanë marrë rreth 30 vërejtje nga NCO. Ka mundësi që nëse vazhdojmë kështu, ne edhe të përjashtohemi. Ishte Italia që po printe në tërheqje të energjisë elektrike dhe Kosova kishte vendin e dytë. Imagjinoni në çfarë situatë.

Në anën tjetër, janë 27,8 milionë euro që janë shpenzuar nga katër komunat veriore dhe llogaritet që diku 10-13 milionë do të shpenzohen deri në fund të vitit. Domethënë, 27,8 milionë euro janë shpenzuar deri më 16 nëntor, e llogaritet 10 - 12 milionë euro të shpenzohen, a nuk ka qenë ky alarm i krizës energjetike, që ju këtë vendim që e keni sjellë sot, ta sillni, le të themi, më 16 nëntor?

Konsideroj që këto kanë qenë indikacione të mjaftueshme që ju të merrnit masa shumë më herët. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministrja Rizvanolli e ka një minutë.

Po, mund ta bëjmë edhe kështu. Në fakt, deri tash tri po konsideroj që u bënë. Deputeti Kokaj, a e ke konceptuar edhe ti në fund të replikës këtë që do ta thuash apo...

**JAHJA KOKAJ:** Unë vetëm desha të përgjigjem lidhur me remontin, pse s'është bërë gjatë verës. Kjo është çështje teknike, ngase janë tri pika, përveç tjerash, janë trakat bartëse, pastaj sistemi termik, sistemi mekanik dhe sistemi elektro-magnetik. Ne nuk kemi sensorë, nuk kemi sistem detektues, as testimin jodestruktues, nuk kemi sistem holografik dhe laserik, nuk kemi adekuatë ultra-zanor, prandaj nuk kemi pasur mundësi të identifikohen këto probleme, të cilat ka qenë dashur t'i kemi moti.

Ne bërthamën shkencore thamë e kemi shkatërruar moti, nuk ekzistojnë këto mënyra të identifikimit. Prandaj, jemi të imponuar të veprojmë kështu ad hoc përderisa nuk e kthejmë aplikimin e shkencës dhe teknologjisë si duhet në ato vende, edhe sikurse mungon në shumë vende të tjera, përfshirë edhe shkollat dhe universitetet tona. Faleminderit!

**KRYETARI:** Edhe deputeti Xhavit Haliti e ka kërkuar një replikë.

**XHAVIT HALITI:** Unë e falënderoj ministren për shpjegimin që e dha, por po mendoj që sipas të gjitha këtyre diskutimeve që i dëgjova, Kosova edhe diku gjashtë vjet derisa ta zbulojnë atë frigoriferin e z. Kokaj për konservimin e rrymës elektrike të energjisë elektrike, ne duhet çdo ditë të kemi këso debatesh, sepse këto janë kapacitetet e Kosovës. Dhe nëse vjen ai frigoriferi, po besoj që me kohë do ta rezervojmë energjinë, ata që e prodhojnë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Abelard Tahiri, ti je paraqitur për fjalë, apo për replikë? Replikë. Edhe z. Tahiri, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, një replikë.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre, i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor, por edhe mbarë Evropën që qytetarët janë të prekur me reduktimet e energjisë elektrike, është Kosova. Pra, kriza i ka përfshirë të gjithë, reduktime nuk ka as në Maqedoninë e Veriut, reduktime nuk ka as në Shqipëri. Këtë e kam të konfirmuar në rrugë zyrtare nga zëvendëskryeministri i Maqedonisë dhe nga ministri përkatës në Republikën e Shqipërisë. Edhe pse janë më keq sesa ne, sa i përket resurseve. Ju e dini që Shqipëria prodhimin e energjisë e ka të bazuar në hidro dhe të reshura nuk ka pasur deri këto ditë.

Në anën tjetër, ju e dini që Maqedonia e Veriut e ka të bazuar në termocentrale prodhimin e energjisë, ndërsa resurse natyrore, thëngjill nuk ka. Dihet prej nga furnizohet. Në këtë rast, këto dy vende, për asnjë orë të vetme, qytetarët e këtyre dyja vendeve, nuk e kanë përjetuar reduktimin e energjisë elektrike. Ndërsa, ne me orë të tëra, shtatë orë, tetë orë e kështu me radhë.

Unë e kam veç një pyetje: A jeni në gjendje të zotoheni që brenda, le të themi që do ta shpallim këtë gjendje emergjente, dhe brenda dhjetë ditëve do të marrë fund reduktimi i energjisë elektrike në Kosovë. Pra, a jeni në gjendje t'u thoni qytetarëve të Republikës së Kosovës, që reduktimet do të përfundojnë, le të themi për një javë, dy ditë, pesë ditë? Unë mund të them që gjendja në Prishtinë është pak më e mirë, fatmirësisht, është pak më e mirë. Po gjendja nëpër qytetet e tjera, në Anamoravë është tmerr. Tetë orë nuk ka rrymë në Gjilan. Gjashtë orë s'ka rrymë në Viti. d.m.th. nuk është çështje e dy orëve. Ka gjashtë orë, tetë orë, dhjetë orë që nuk kanë rrymë në Anamoravë. Kjo ka qenë edhe revolta e qytetarëve që kanë sulmuar zyrat e KEDS-it. Pra mungesa e energjisë elektrike nuk bëhet llaf për dy orë. Është tepër më e madhe në shumë vende të Kosovës.

KRYETARI: Tash ministrja mund të përgjigjet.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit!

Po filloj me pyetjet e deputetes Bajrami. Nuk e kemi parë të arsyeshme shpalljen e gjendjes emergjente në fund të tetorit, kur kanë filluar devijimet, të cilat atëkohë kanë qenë për shkak të komunave veriore, dhe kanë qenë në masë më të vogël. Ka qenë mesi i dhjetorit kur devijimet kanë filluar të rriten, posaqërisht nga data 20 dhe 21, kur gjendja është bërë alarmante dhe për shkak të mosimportimit nga ana e KESCO-s. kemi pasur paralajmërime, është e vërtetë nga KESCO-s dhe KEDS-i se situata po përkeqësohet, mirëpo kemi dashur të presim të sigurohemi që KESCO dhe KEDS-i janë duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet për të arritur likuiditetin e nevojshëm për të kryer obligimet që i kanë sipas licencës së tyre.

Më duhet të them se duke e pasur një kompani private të distribuimit, dhe duke e pasur një kompani të distribuimit private me të njëjtin pronar sikurse edhe furnizuesit, që është monopol efektivisht, e ka bërë më të vështirë ndërhyrjen dhe më të ngadalshme, edhe për faktin që siç e

thashë më herët, përkundër faktit që këto dy kompani duhet të funksionojnë si të ndara, në fakt ne kemi dyshime se këto kanë ndërvepruar gjatë kësaj kohe dhe në fakt ne jemi kushtëzuar për ta paguar energjinë për qytetarët, e cila duhet të shkojë përmes KESCO-s si furnizuesi kryesor. Ne jemi kushtëzuar për disa ditë me nënshkrimin e marrëveshjes mes KEK-ut dhe ta, për shkak se kanë dashur, kanë insistuar që edhe për KEDS-in të bëhet subvencionimi.

D.m.th. fakti, mund të them, prej përvojës gjatë atyre ditëve kur janë nënshkruar këto marrëveshje, fakti që ne kemi, por edhe në këto ditë pikërisht janë bërë edhe reduktimet, për shkak të vonesave në marrëveshjen KEK-KESCO.

Marrëveshjen me KEK-un, Ministria e Ekonomisë e kemi bërë për një ditë, një të shtunë deri në 11 të natës, përderisa KESCO-s i janë dashur katër ditë për ta nënshkruar një marrëveshje me KEK-un. Gjatë këtyre katër ditëve, dy ditët e fundit situata është bërë e papërbalueshme dhe KOSTT-i për të ruajtur sigurinë e sistemit, si në vend, ashtu edhe sistemit energjetik në vend dhe jashtë vendit, është dashur të bëjë reduktime, për mosnominime të cilat fillimisht kanë ardhur në mungesë të nominimeve nga KEDS dhe KESCO. Madje, edhe përderisa flasim, edhe kjo lidhet me pyetjen a mund të garantojmë dhe për sa mund të garantojmë që nuk do të ketë reduktime, këtu janë dy çështje. E para është që me mjetet të cilat i kemi ndarë, ne kemi mbuluar të gjithë...

**KRYETARI:** Zgjatjani edhe një minutë fjalën ministres.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Faleminderit!

Me mjetet që i kemi ndarë, ne kemi mbuluar konsumin për të gjithë konsumatorët e rregulluar, d.m.th. të gjithë konsumatorët shtëpiakë dhe bizneset, me përjashtim të tri bizneseve që janë të ndarë në treg të lirë, e kemi mbuluar konsumin për ta. Mirëpo, edhe përderisa flasim, KEDS është duke vazhduar të mos e nominojë kërkesën e duhur dhe të mos e blejë energjinë e duhur për ta mbuluar pjesën e humbjeve të rrjetit të vet dhe si pasojë e kësaj, ne edhe pse e kemi dhënë subvencionin për të garantuar furnizimin për qytetarët, nuk mund të jemi qind për qind të sigurt se reduktimet nuk do të ndodhin, për shkak të devijimeve të cilat po i bën KEDS-i.

Për t'u përgjigjur në pyetjen e deputetit Tahiri, dy ditë ka pasur reduktime me plan, të planifikuara. Orari ka qenë tetë me dy. Që prej pardje nëse nuk gaboj, pas atyre dy ditëve, nuk duhet të ketë më reduktime.

**KRYETARI:** Ministre, e kam një propozim, ju lutem. Ministre, dëgjoj krejt deputetët që kanë për të folur dhe e ke fjalën e fundit për të mbyllur diskutimin. Aty ke minuta mjaftueshëm për të shpjeguar të gjitha.

I kemi edhe pesë a gjashtë deputetë që do të flasin.

Tash, z. Hoti a jeni paraqitur për replikë, apo do ta keni fjalën e plotë? Fillimisht ia japim deputetit të PDK-së, i cili është në radhë, Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Media të pranishme,

Të dashur qytetarë,

Unë e shoh Qeverinë si mekanizëm i sinkronizuar i veprimit institucional dhe me plan. Qeveria duhet të planifikojë qeverisjen dhe vetëm në këtë formë do të mund të identifikohen mundësitë e krizave, burimet e tyre, të mundësojë mbledhjen e informacionit me kohë dhe marrjen e masave adekuate për parandalimin dhe sanimin e tyre. Kështu i krijon edhe vetes hapësirë të nevojshme për vlerësim të situatës në vazhdimësi.

Ushtria është art, ndaj edhe unë kam mendimin e standardizuar për veprim me plan. E planifikim d.t.th. të parashikohen përpara dhe me kohë. Pra, nuk guxojmë të zihemi në befasi, siç na ndodhë shpesh kur bie bora e parë. Kriza nuk është krijuar brenda natës. Hiç fatkeqësitë natyrore të cilat duhet po ashtu ta kenë kohën rezervë, mjete dhe resurse e masa për t'i tejkaluar. Dëmet në politikën e jashtme janë të riparueshme, por në aspektin e brendshëm nuk mund të arsyetohen, as të mbulohen me atë se kanë bërë gabime qeveritë e kaluara e të vazhdojë edhe vetë të bëjë gabime. Jo. Kjo Qeveri ka premtuar ndryshim dhe stabilizim edhe ekonomik, edhe politik. Ndaj, edhe me të drejtë, qytetarët kërkojnë dhe presin nga ju.

Detyra e një udhëheqësi është t'i balancojë resurset, si humane, materiale apo edhe kursin e veprimit politik për tema të caktuara. Pse Qeveria nuk i ka krijuar rezervat e duhura energjetike, kur është pritur që do të ketë krizë energjetike në Evropë? Si Kryeministër që ju kemi, edhe ministrat, dhe duke ju njohur si një teoricien deri në dogmat, pres që ta arrini të vini në paaftësitë tuaja për menaxhimin e situatave të paparashikuara. E këtë mund ta bëjë vetëm dikush që është i thelluar në shkencë.

Për ju do të duhej të jenë të panjohura këto koncepte, si 'unexpected situation management', 'high reliability organization' ose 'early warning signals'.

Puna si ushtarak, për një kohë të gjatë më ka mundësuar t'i njoh këto procese të vështira dhe tash të paparashikueshme. Edhe punën në situata me rrezikshmëri të lartë.

Zoti Kryeministër, çdo ditë të sfidave që po ju jep qeverisja, ju nuk po i kurseni qeveritë e kaluara duke iu adresuar me aktakuza ndaj të kaluarës dhe punës së tyre. Pse atëherë nuk po veproni me drejtësi? A mos kjo po ju jep arsye që të sillni kuadro nga shkollat e Kumrovcit për t'i tejkaluar situatat? Jo, zoti Kryeministër. Lirohu nga qeverisja me jugonostalgjikë, me

koncepte dekadente të së kaluarës komuniste, kur energjetike, apo energjia konsiderohej si një resurs ekonomik dhe nga ajo fitohej përmes taksave të rrymës, apo pagesës së rrymës. Ky resurs sot është dhe gjeostrategjik, e besa edhe me impakt të madh politik.

Unë si deputet, ta zëmë e përkrah iniciativën tuaj me Maqedoninë, dhe kisha kërkuar që Qeveria të kërkojë nga kompania Kosova thëngjill a po, që ta rrisë kapacitetin e thëngjillit dhe t'ia ofrojmë këtë tregut rajonal, kështu që duke shitur thëngjill, edhe të krijojmë rezerva energjetike.

'Early warning signals' apo sinjalet e hershme të një krize në ardhje veç e kemi pasur qe tetë muaj dhe është folur për krizë energjetike. Kështu që, zoti Kryeministër, mos u bë si një kandidat që e ke caktuar për ta udhëhequr Prishtinën e sa kam mësuar, çdo mandat i kanë mbetur tepër nga 60 milionë. Çile mendjen, çile zemrën, fol me ne. Komunikoj me ne, se nuk jemi armiq. Jemi vetëm kundërshtarë politikë, por Kosova është mbi të gjitha.

Platoni thotë se ku është dallimi mes kombeve a vendeve të civilizuar dhe atyre barbare. Vendet e civilizuar vendosin standarde. Vendosini edhe ju zoti Kryeministër, po jo në mënyrë selektive. Pse po e ngarkoni sistemin tonë energjetik dhe qytetarët me masa e kufizime të rrymës? Kështu po krijoni ende favore për do fabrika që përfliken në veri që prodhojnë bitcoin, furra, zdrukthetari e ku ta di unë, e ku involvohen struktura kriminale që nga Daçiqi, që nuk di çfarë pozite ka në Serbi e deri te këta lokalë. Ju veproni, por veproni nga buxheti i shtetit, jo duke i rënduar, apo duke i dënuar qytetarët dhe amvisëritë tona.

Qe dhjetë muaj nuk po shohim ende punë të cilat Kosovën do ta bënin funksionale. Ju kujtoj që në të gjitha kufizimet që kanë pasur qeveritë e pas pavarësisë, qoftë me atë brutoproduktin që ka qenë diku tre-katër miliardë, apo buxheti 600 apo 700 milionë, me kohë u arrit të përmirësohet furnizimi me energji. U arrit të bëhen investimet të duhura në rrjet, në riparimin dhe mirëmbajtjen e duhur të KEK-ut, si dhe u hap rruga për investime në energji të gjelbër.

Sot Kosova, sipas informatave, i ka 230 MW prodhuar nga energjia e ripërtëritshme, në Kamenicë ishin 37 MW, në Shalë atje 105, pastaj 62 MW nga hidrocentralet dhe disa megavate nga panelet diellore. Kemi rreth 800 MW që priten e janë aplikacione, autorizime për energji të ripërtëritshme. Pse këto kapacitete nuk po mund të ndërtohen ende apo nuk po lëshohen në punë? A është pikërisht detyrë e Qeverisë suaj tash në pozitë që ta sanoni dëmin që është bërë gjatë kohës sa ishit në opozitë dhe i pengoni të gjitha këto? Pra, kjo tregon se është bërë diçka edhe atëherë kur ju ishit në opozitë nga qeveritë e kaluara.

Ju dëshmuat ditë më parë se po vazhdoni me po këtë frymë të refuzimit, bazuar mbi atë formulën e forcave vetanake, apo sloganin që përkon me ideologjinë tuaj, edhe bar do të hamë. Duke refuzuar fondet e MCC-së, këto të fundit dhe ato të mëhershmet, duke refuzuar projektin amerikan dhe ndriçimin amerikan për t'u ngrohur me batanije kineze. Kjo d.t.th. në vështrimin



tim se kriza të tjera të thella do të ketë në vazhdim dhe se kriza është politike. Ndaj qytetarët e Kosovës duhet të shtrëngojnë rripat, se udhëheqësit me dyshtetësi do ta rrokullisin edhe më tutje Kosovën.

Në kohën e qeverisjeve të kaluara, edhe në Shalë, edhe në Dushkajë time, edhe në Llap, janë dëgjuar qytetarët të pyesin se ku po i kalojnë pushimet verore, a në Durrës, a në Ulqin, a Turqi, e besa edhe në Greqi. Sot i dëgjoni qytetarët duke pyetur ku është buka më lirë. Ku ka mish të pulave të Polonisë, që nuk dihet a janë minj të bardhë apo çka janë. Kjo është tregues i një qeverisje jo të mirë të cilën po provoni ta rëndoni edhe më shumë me këto masa që i keni sjellë sot. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Tash fjalën ia japim deputetit të LDK-së, Avdullah Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e mora fjalën për të dhënë opinionin tim dhe disa sqarime. Besoj t'i kontribuoj këtij debati. Besoj që në shumicën e fjalimeve u qartësuan gjërat. Disa deputetë flasin edhe me kompetencë teknike profesionale, se mund të jenë të fushës, po atë që unë vlerësoj, në fakt kjo krizë nuk është që e ka krijuar kjo Qeveri drejtpërdrejt. Ne jemi pjesë e një krize regjionale dhe më gjerë të furnizimit me energji.

Po është fakt që kanë munguar vendimet operative për t'u përballur me këtë krizë. Tash unë e kam të qartë që Qeveria nuk merr vendim për ta qar Kosovën B në remont. Po ministri i përgjegjës që e mbulon fushën e energjisë, i bën koordinimet e nevojshme edhe me KEK-un, edhe me KEDS-in e ndërmarrjet e tjera publike ose private që janë të fushës së energjisë, për t'u siguruar që kur të vijë dimri, ne jemi të përgatitur për këtë gjë. Gjithashtu, ministri i Financave është bukur ekspert i fushës së financave, sepse mesa di merret me, çështje e tij private sigurisht, edhe e respektoj plotësisht, me atë tregjet e kriptovalutave. Pra, e ka të qartë se si funksionojnë tregjet financiare, bursat e të tjera. ai e di dhe është dashur ta këshillojë kryeministrin se energjia ka pasur mundësi të blihet, të rezervohet shumë më herët. Por, kanë munguar vendimet operative në afat të shkurtër për t'u përballur me këtë situatë.

Nuk po flas për qasjen afatgjate, pra strategjinë afatgjate të kësaj Qeverie, e cila tek tash ka filluar të mendojë. Dhe krejt çka është bërë në aspektin e planifikimit për sektorin e energjisë, e ka hedhur poshtë. Me të drejtë apo pa të drejtë, tash situata po na tregon shumë qartë në këtë drejtim.

Unë dua të përmend shumë shkurt, vetëm projektet që janë refuzuar me MCC, pjesë e studimit të MCC-së, këto dy-tri vite që janë bërë në fushën e energjisë për të identifikuar burimet

energjetike afatgjate, për të siguruar stabilitetin afatgjatë energjetik të Kosovës. Ka qenë gypi i gazit Prishtinë-Shkup, gjoja se sjell gaz rus në vend, termocentrali i gazit me 200 MW. Kanë qenë të planifikuar bateritë akumuluese për energji, të shtrenjta sigurisht. Kanë qenë pjesë e propozimit që ka bërë MCC. Pra rryma tash mund të akumulohet. Nuk ka nevojë për fraza të tilla siç i kemi dëgjuar. Gjithashtu edhe investime në rrjetin shpërndarës, për të zvogëluar humbjet që shkojnë 15 apo 20 për qind të energjisë që humbet në rrjet. Krejt këto projekte të bazuara në një studim të parafizibilitetit të MCC-së për dy tri vjet në radhë janë refuzuar në muajt e verës dhe këtu kemi pasur debat të gjatë për këtë çështje.

Tash ministrja më duket ose ministri i Financave, njëri nga ta, tha që problem është vërtet privatizimi i distribucionit, sepse në atë kontratë, unë nuk i di detajet saktë të kontratës, por KEK-u duhet t'ia shesë, e ka për obligim që t'ia shesë energjinë KEDS-it, KESCO-s në këtë rast. Por, nuk e përmendi edhe nenin tjetër, i cili thotë që KEDS-i e ka për obligim që ta furnizojë Kosovën me energji. E ka për obligim që ta furnizojë Kosovën me energji.

Tash, vijmë te vendimi i Qeverisë. Pra, nëse është kjo kontratë në fuqi, pse nuk po insistoni që ta respektoni kontratën KESCO dhe KEDS, ta furnizoni Kosovën me energji.

Kur ne po e shesim 30 e sa euro MW, jashtë çdo çmimi të tregut. Ky e ka për obligim që pjesën tjetër që ne nuk mund ta prodhojmë vetë, ta furnizojë Kosovën me energji. Në fund të fundit, e dini çfarë sjell ky vendim i Qeverisë, i cili kërkohet që të miratohet tani këtu në Kuvend? Do të kenë pasoja bizneset, sepse ato janë konsumuesit më të mëdhenj në këtë kohë të energjisë, dhe atyre do t'iu shtohen reduktimet. Dhe, përtej kësaj, e dini se çfarë ndodh në praktikë? Më nuk do të ketë mundësi asnjë qytetar dhe asnjë biznes të padisë KEDS-in, KESCO-n për mos-furnizim të rregullt me energji elektrike.

Dhe krejt ato thirrjet e ministres që thoshte që, kushdo që po jeton reduktimet e energjisë më shumë se dy orë, le t'i lajmërojë në polici, tash ju e mbuloni KEDS-in me këtë vendim. S'mundet askush që ta padisë KESCO-n dhe KEDS-in për mos-furnizim të energjisë. Kjo është e vërteta për këtë vendim dhe për të gjithë këtë debat që jemi duke e bërë në Kuvend. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Para se të shtroj pyetje dhe interesimin tonë për shpalljen e gjendjes emergjente, i keni parë ato dritat ndezur natën në Qeveri. Kryeministri Kurti ulur në njërin anë, komiteti, ministrja e ulur në anën tjetër, nja dhjetë minuta qetësi duke e shikuar njëri-tjetrin në sy, prit kur po fillojnë të flasin të japin propozimet, prit, urdhëroni? Kryeministër, e kemi një dilemë.

Qysh është e mundshme të ketë krizë energjetike në Kosovë duke ju pasur juve kryeministër? Kryeministri po përgjigjet, po parafrazon, ishim të paralajmëruar me kohë. Edhe vendet fqinje morën masa emergjente.

Ministrja me komitetin, në stilin militant, edhe ata që i ka emëruar, edhe ata mbi moshën 75-vjeçare, të pakënaqur me përgjigjen, po i drejtohen; kryeministër, nuk ka terr që të sfidon ty, sepse ti je yll që ndriçon botën, e lëre më Kosovën.

Ndonëse me vonesë, por tashmë të gjithë e kanë kuptuar që terri i Kurtit është vetë drita e vendit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar ministre,

Kriza nuk fillon sa hap e mbyll sytë. Qeveria e ka ditur që po shkojmë drejt një krize energjetike. Çfarë keni bërë? Edhe sot deklaruat, asgjë. Çka keni reaguar? Si keni reaguar? Hiç, fare.

Ju duhet sot që na tregoni, t'u përgjigjeni deputetëve në mënyrë shumë racionale për gjendjen e menaxhimit të burimeve energjetike në vendin tonë, për ta bindur për ta votuar shpalljen e gjendjes emergjente.

Çka ka Kosova? Çka ofron? Cila është gjendja, me çka ju po merreni dhe si do të merreni?

Si Qeveri e Republikës së Kosovës, në këto festat e fundvitit, në vend se të ofroni ngrohtësi në familjet tona edhe në familjet e qytetarëve të varfër e të pasur, ka muaj të tërë që ju keni ofruar rritje të çmimeve, edhe të bukës, edhe të drithërave, edhe të djathit, edhe të vezëve, edhe të vajrave, edhe të yndyrave ushqimore, edhe të produkteve të qumështit, e të gjitha, të gjitha me radhë.

E tash, duhet të na tregoni me sinqeritet, a do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike apo do ta mbuloni nga Buxheti i Republikës së Kosovës? Çka do të ndodh pas 31 dhjetorit të këtij viti? Këto janë pyetje që na interesojnë neve dhe u interesojnë deputetëve të Republikës së Kosovës.

Qytetarëve të ndershëm iu intereson se a duhet të vazhdojnë të paguajnë faturat në mënyrë të rregullt, edhe ata që marrin pensionet e vogla, dhe të kenë reduktime, e të përballem me reduktime, dhe çfarë do të bëni ju për mbledhjen e tarifave në pjesën veriore, ku ata nuk paguajnë dhe kanë 24 orë pandërprerë energji elektrike.

Duhet të theksojmë, jo me të drejtë, por as pa të drejtë, se ju vetë e keni deklaruar këtë në vazhdimësi këtu në Kuvend dhe kudo që e keni potencuar.

Po i përmendi vendet tjera që kanë marrë masa emergjente. Merreni dhe lexoni dhe studioni vendimet e tyre. Ata kanë vendosur masa emergjente, por në vendimet e tyre kanë garantuar furnizimin me energji.

Vendimi i juaj flet vetëm për kufizime, e jo për zgjidhje dhe nuk jep asnjë garant për furnizim të rregullt me energji. Këto janë pyetje për Qeverinë. Këto janë pyetje për juve ministre e nderuar, pa dashur të theksojmë ose të përsërisim ose të mos e teprojmë me përsëritjen që me popullizma dhe me demagogji nuk zgjidhen problemet e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Besian Mustafa.

**BESIAN MUSTAFA:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Sot, ballafaquar me një krizë energjetike që shkon përtej interesave partiake, individuale dhe politikave ditore. Pra, ballafaquar me një krizë të interesit kombëtar, ne këtu 120 deputetët e Kuvendit dhe i gjithë Kabineti qeveritar i Republikës së Kosovës, do duhej të ishim të bashkuar duke kërkuar zgjidhje të shpejta për të nxjerrë qytetarët dhe vendin nga kjo krizë.

Do duhej të ishim të bashkuar duke i dhënë krahun njëri-tjetrit pa qarë kokën se kush është në pushtet e kush në opozitë, kush i majtë e kush i djathtë, kush i ri e kush i vjetër, e çfarëdo dallimi tjetër.

Sepse, interesat kombëtare janë përtej dhe mbi çdo interes tjetër, çdo gjë tjetër, e veçanërisht inati zemërngushtë politik nënshtrohet para interesave kombëtare. Secili prej nesh si deputet, grupe parlamentare, ministra, zëvendëskryeministra dhe kryeministër, mbartim përgjegjësi për respektimin, mbrojtjen dhe avancimi e interesave kombëtare, kush më shumë e kush më pak.

Në demokraci kjo përgjegjësi ndahet sipas fuqisë politike. Ata që marrin më shumë vota, thjesht, kanë përgjegjësinë më të madhe. Në këtë rast, pushteti gjithnjë ka përgjegjësinë më të madhe, të ruaj, të mirëmbajë dhe avancojë demokracinë në një vend, njësoj edhe me unitetin kombëtar dhe unitetin e spektrit politik. Sa më i fuqishëm pushteti, aq më e madhe përgjegjësia për të shtruar rrugë që na bashkojnë.

Fatkeqësisht, ky pushtet nuk tregon se e kupton këtë gjë. Në vend që të angazhohet për të siguruar bashkimin e të gjitha forcave politike në Kosovë, për të gjetur zgjidhje që sa më shpejt që të dilet nga kjo krizë shtetërore, ky pushtet shpenzon orë e ditë të tëra duke e fajësuar gjithkënd tjetër për situatën e sotme.

Më e keqe se kjo, duke i mbushur orët e ditë me ankesa e akuza. Duke mbushur orët e ditët duke bërë me gisht drejt të gjithë të tjerëve, s'iu ka mbetur asnjë ditë, orë, minutë e sekondë për të gjetur zgjidhje.

Në vend se të trasojnë rrugë që ofrojnë të gjithë në Kosovë për të punuar së bashku drejt daljes nga kjo krizë, shihet që kjo gjë as u ka ra ndërmend. Edhe sot në këtë seancë plenare, në vend të gjetjes së pikave që na bashkojnë, pushteti do të hedhë akuza siç hodhi për 22 vitet e fundit, për 22 vitet para atyre 22 viteve, e deri te Skënderbeu, e deri tek organizmat njëqelizor parahistorik si gjithnjë.

Do të bëjnë gjithçka për të na ndarë, e asgjë për të na bashkuar. Këtë lloj mendësie e kanë instaluar vetë. Të paaftë që të bashkojnë politike në vend për të gjetur zgjidhje, dhe të paaftë që të gjejnë zgjidhje vetë, krijojnë dhe ekzekutojnë skenarë kompleks, ku synojnë të dalin heronj vetë.

Ani pse në proces e sipër dëmtohen qytetarët, ekonomia, interesi kombëtar dhe gjithçka tjetër, me rëndësi të shihen si heronj në katrahurën që krijojnë vetë.

Kanë mundur të nënshkruajnë kontrata për furnizim me energji elektrike me çmime shumë më të volitshme shumë muaj më parë. Mund të shajnë kapitalizmin sa të duan, por në kapitalizëm në ekonominë e tregut, të cilën e përmendin vetëm për të fajësuar atë për dështimet e tyre, kontrata përbën ligj për palët.

Në komunizmin e Zhizhekut që këta ëndërrojnë s'ka kontrata fare, ka veç pushtet absolut dhe qytetarë vasalë. Pra, sikur të kishin nënshkruar kontrata me kohë, sot të kishim energji në sasi e me çmim shumë më të volitshëm.

Kanë mundur edhe të mirëmbajnë blloqet e KEK-ut gjatë verës, kur konsumi i energjisë ka qenë shumë i ulët, por s'i ka lënë paranoja. Kanë menduar që çdo veprim në Kosovë është hajni dhe krim. S'ka lidhje që Bordin dhe kryeshefin e KEK-ut i kanë emëruar vetë. S'ka lidhje që Bordin e ZRRE-së, e kanë emëruar vetë, bashkëpunëtorët e tyre. S'u besojnë as atyre.

S'ka lidhje që kur erdhën në pushtet nuk kishte reduktime, kishte drita, sepse sipas tyre, të gjithë para tyre ishin kriminelë. Terri i këtyre është më i ndritshëm se drita e atyre.

Duke mos ditur të na bashkojnë që të gjejmë zgjidhje, duke mos ditur të gjejnë zgjidhje vetë, vendosen si gjithnjë të bëjnë një kurban. Në këtë rast, ministren e Ekonomisë.

Besoj që nuk ka kosovarë që nuk e ka kuptuar lojën e tyre me kinse protestat e tyre dje, që më shumë ishin të interesuar të shkarkonin ministren Rizvanolli, e të rinacionalizonin KEDS-in, sesa të shprehnin pakënaqësitë e tyre. Kjo nuk është diçka e re.

Sa herë që këta kanë pasur mundësinë të përfitojnë pak poenë politike në kurriz të reputacionit të politikanëve të tjerë, e kanë bërë këtë me shumë kënaqësi. Aq që kanë qarë kokën që për të fituar pesë-gjashtë vota më shumë, i kanë shkatërruar jetën një vajze apo djali të ri, që ka lënë çdo gjë tjetër në jetë dhe ka hyrë në politikë për t'i shërbyer vendit të vet.

Me shumë lehtësi kanë shkatërruar plotë djem e vajza duke i deklaruar hajna e kriminelë, të korruptuar e çfarëdo tjetër, veç sa për të nxjerrë edhe pak vota nga ndonjë qytetar i frustruar.

Sot po e bëjnë të njëjtën gjë me vetë ministren e tyre. Nejsë. Këta nuk e konsiderojnë të tyren, se nuk është e partisë së tyre. Fundja, edhe po të ishte e partisë së tyre, sipas mendësisë së tyre, ajo do duhej të ndjehej krenare që po e bëjnë kurban. Plus, fakti që paska, si ishin ata titujt në gazeta, qindra-mijëra euro në bankë. Më falni, po pse bëhet kjo temë bash tash? Çka ka rëndësi xhirollogaria personale e ministres? A po, natyrisht, tash do ta shpallin kapitaliste anti-rinisë dhe kundër-revolucionare, anti-kombëtare, isteare, e isteare deri në shkarkim.

Jo, mos e shkarkoni ministren Rizvanolli, një ekonomiste profesioniste që ka la gjithë karrierën prapa për t'i kontribuar vendit të saj. Përkraheni dhe fuqizojeni që ajo të gjejë zgjidhje. Fundja, qytetarët ju kanë votuar që t'u ofroni zgjidhje në problemet e tyre, e jo për t'u ofruar kurban. Ne si deputetë duam zgjidhje, e jo kurban.

Në vend të ofendimit që i bëni asaj duke deklaruar se ju dhe ajo po punoni që të gjeni zgjidhje, fuqizojeni ministren, kryeministër, që ajo të gjejë zgjidhje. Fundja, edhe egoja e juaj i nënshtrohet interesit kombëtar. Në vend që të shkarkoni dhe të dërgoni në burg zëvendësministrin që u zu publikisht duke nënshkruar kontratë multi-milionëshe të jashtëligjshme për stikersa me kompani me pesë punëtorë, atë e mbronni dhe e ruani.

Lojërat tuaja, kompleksët që i sajoni për të shndërruar veten në heronj në katrahurat që i krijoni vetë, i kanë kuptuar tanimë të gjithë. E obliguat KOSTT-in të paguaj faturën e rrymës në veri, e pastaj i thatë KOSTT-it që nuk ka nevojë dhe nuk e pranoni dividendën e tyre.

Pra, paguat rrymën në veri, por tash jo nga xhepi i majtë i qytetarëve, por nga xhepi i djathtë dhe në proces e shpallët veten heronj. Njëmend, atëherë kur e paguat rrymën në veri, thatë dhe patët deklaruar se për gjashtë muaj do ta shtrini pushtetin atje dhe të gjithë atje do të paguajnë rrymën. Gjashtë muaj kanë kaluar moti.

Ia dhatë KEK-ut dhjetëra-miliona euro subvencione, ku të gjitha centë më centë do të përfundojnë të KEDS dhe KESCO. Pra, ia dhuroat dhjetëra-miliona euro një kompanie private nga xhepi i qytetarëve dhe në proces shpallet veten heronj.

Sot, duke qëndruar rrahagjoks mbi grumbullin e problemeve që shkaktuat vetë dhe qeshni pa e ditur as vet pse, ju u kërkoni qytetarëve të vendosin, a doni shtrenjtim të rrymës apo reduktim të rrymës. Natyrisht, në këtë krejt katrahurë që krijuat vetë, e shpallni veten heronj.

Maskat u kanë rënë, s'jeni heronj. Jeni vetëm përçarës që në vend të respektit dhe bashkëpunimit për të ndërtuar ura lidhëse me forcat e tjera politike në Kosovë, sillni me vete vetëm akuza dhe linçime.

Kur vijnë ditë si kjo sot që do t'u shërbente më së miri bashkimi i të gjitha forcave politike në vend, për të gjetur zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për problemet kombëtare, do ta gjeni veten të vetmuar, duke u përpjekur të gjeni dikë, këdo, për të fajësuar, por s'do ta gjeni dot askënd, përveç vetes.

**KRYETARI:** Dhe e fundit për diskutim në këtë pjesë është deputetja Marigona Geci.

**MARIGONA GECI:** Faleminderit, i kryetar i Kuvendit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Tani, duke i dëgjuar diskutimet e partisë në pushtet dhe partive opozitare, po shihet se zgjidhje e krizës energjetike, është larg.

Tani se si qëndron situata me energji elektrike po e shohin të gjithë qytetarët, prej amvisërisë, ekonomitë familjare, e deri te kompanitë që harxhojnë energji elektrike.

Mua po më intereson se cilat është zgjidhja në kushtet e tanishme, sepse po duket qartë se keni gabuar në hapa për t'i marrë masat në kohë për parandalimin e krizës energjetike. Dhe, këto arsyetimet e juaja sot, janë arsyetime koti dhe nuk sanojnë krizën tani.

Unë kërktoj nga Qeveria transparencë dhe llogaridhënie për këtë situatë dhe derdhje të miliona eurove pa transparencë dhe pa llogaridhënie. Kërktoj nga Qeveria t'u tregoj qytetarëve se cilët janë hapat që ju do të merrni për përmirësimin e gjendjes aktuale. Ku do ta blini energjinë. Sa do të jetë çmimi i blerjes së 1 MW. Sa do të jetë çmimi i shitjes apo i furnizimit. Fundja, qytetarëve u intereson se a do të kenë energji elektrike dhe sa do të paguajnë për energjinë e konsumuar. Kaq u intereson atyre.

Kryeministri para disa ditëve, qytetarëve u ka ofruar dy zgjidhje të këqija në formë pyetjeje, i ka ofruar dy zgjidhje për qytetarët: a po doni t'ju shtrenjtoj çmimin e energjisë e ta keni energjinë me çmimin 50% më të shtrenjtë, apo doni të keni reduktime gjatës ditës, e të paguani çmimin e tanishëm. Asnjëra nga këto nuk është zgjidhje për qytetarët.

Meqë kryeministri nuk është këtu, ju zonja ministre, na tregoni zgjidhjen që do ta bëni. Që nuk kemi energji po e dimë, dhe që keni për ta shtrenjtuar energjinë në kundërshtim me premtimet e juaja, po e dimë edhe këtë. Dhe, nëse nuk do të ngrihen çmimet e energjisë, që nuk do të kemi energji, prapë po e dimë.

Nuk keni ardhur në krye të shtetit për të mos ofruar zgjidhje. Ofroni zgjidhje që t'ju mbështesim edhe ne, se kriza është e të gjithëve. Të mos kërkonit fajtor në qiell, por gjeni zgjidhjen këtu në tokë, në KEK, në KOSTT, në Qeveri dhe në importe me transparencë dhe llogaridhënie. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Edhe Armend Muja e ka kërkuar fjalën për diskutim tash.

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Po besoj në këtë diskutim është e rëndësishme të fillohet pak me historinë, jo se duam, por që disa probleme vërtet datojnë nga ajo.

Po e shfletoj, në mars të vitit 2018 një interpelancë, tri interpelanca të thirrura nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje në atë kohë, zoti Glauk Konjufca, një interpelancë të thirrur nga LDK-ja dhe interpelancë tjetër nga një grup tjetër parlamentar, kundër ish-kryeministrit Haradinaj.

Dhe, në atë interpelancë Lëvizja Vetëvendosje del me këtë propozim-rezolutë:

1. Të miratohet bilanci afatgjatë i energjisë,
2. Rindërtimi i Kosovës A,
3. Planifikimi për remont i Kosovës B,
4. Ndërprejja e kontratës me Contour Global dhe,
5. Vendosja nën mbikëqyrej strikte të investimeve të KESCO-s për rritjen e shpërndarjes dhe kontrollin e humbjeve teknike.

Evidente është kjo, fillimisht ka një paqartësi ose pasaktësi sa i përket aludimit për blerje të menjëhershme të energjisë. Në bazë të Ligjit për Rregullatorin e energjisë, ciklet e planifikimit bazohen me bilancin afatgjatë të energjisë. Për bilancin afatgjatë konsultimet ndodhin në nëntor e



dhjetor të vitit paraprak, që në këtë rast është dashur të ndodhnin në nëntor ose dhjetor të vitit 2020 dhe ato aprovoen deri në mars të vitit 2021.

Ajo çka është evidente në bazë të konsultimit që KESCO, në fakt, ka kërkuar nga ZRRE-ja në atë kohë që të rishikohen çmimet, në mënyrë që atyre t'u mundësohet një blerje afatgjate e energjisë. ZRRE-në atë kohë nuk e ka kontrolluar zoti Kurti, ZRRE-në e kanë kontrolluar partitë në pushtet. E dyta, rritja e çmimit të energjisë daton që nga janari 8 janari i vitit 2021, s'ka qenë zoti Kurti në pushtet në atë kohë, çmimi ka shkuar në bursën e Hungarisë 120 euro për megavat orë. Pra, para se të vijë qeveria Kurti dhe të gjitha këto planifikime, nëse është dashur, është dashur t'i bënin qeveritë paraprake, se kontratat Future Markets bëhen paraprakisht, Future lidhet me çmimin, Forward lidhet me furnizimin.

Tjetra, rindërtimi i Kosovës A. Ka ekzistuar në vitin 2015 një propozim nga kompania gjermane Bilfinger, me mbështetje nga kancelarja gjermane, e paraqitur nga i ndjeri Avni Kurshumliu, për renovimin e Kosovës A. Në atë kohë Qeveria Mustafa nuk e ka marrë seriozisht. I dimë detajet, detaji ka qenë që Kosova A të rritet nga 400 në 800 megavatë energji, për 800 milionë euro, nga të cilat 300 milionë euro i siguron Kosova dhe 500 milionë euro BERZH-i. Po, ky është dështimi paraprak në kapacitet të gjenerimit. Tjetra, remonti i Kosovës B, shikoni raportet e KEK-ut të vitit 2019 dhe të vitit 2020, në vazhdimësi thotë do ta kemi të pamundur ta bëjmë remontin qoftë për shkak të pandemisë, qoftë për shkak të pamundësisë të kontraktimit të furnizuesve, pra është problem që daton nga e kaluara.

Tjetra, KESCO. Furnitori i energjisë është KESCO, nuk është qeveria dhe duhet t'ju rikujtoj që në vitin 2008 deri në vitin 2012 ka vazhduar procesi i privatizimit të KESCO-s. Është shitur krejt rrejt i furnizimit dhe distribuimit për 26.3 milionë euro. Dua t'ju rikujtoj dy elemente: 20 milionë euro iu kanë dhënë në avans, faturat që ia kanë pasur qytetarët borxh KEK-ut, e dyta, hidrocentralet po ashtu që kanë kushtuar 20 milionë euro. Pra, është një faturë. Duhet ta rikujtoj zonjën Bajrami, që në atë kohë Haki Shatri në emër të LDK-së e ka mbështetur këtë proces të privatizimit. Duhet ta rikujtoj edhe Grupin Parlamentar të AAK-së që Ethem Çeku në atë kohë e ka mbështetur këtë proces të privatizimit dhe 67 aktivistë më të devotshëm të Vetëvendosjes, përfshirë Albin Kurtin, janë arrestuar në atë kohë në kundërshtim të këtij privatizimi të egër. E fundit, evidente është që ka pasur pak mendim ose vizion për prodhimin ose gjenerimin e kapaciteteve shtesë.

Një propozim e kemi pasur të Contour Global, dua ta rikujtoj zonjën Bajrami që po ashtu në vitin 2017 edhe LDK-ja e ka kundërshtuar, në fakt si folëse kryesore pasionante për ta kundërshtuar Contour Globalin në faqe 404 të këtij procesverbali jeni edhe ju. Pra, ideja kryesore është kështu: një arsye se pse deputetët kanë pak rejting në shoqëri është mungesa e konsistencës. Ajo çka ne mund ta dokumentojmë është që Lëvizja Vetëvendosje në mënyrë konsistente prej vitit 2010 e ka

vënë në spikamë nevojën për kapacitete të reja, nën dy, nevojën dhe kundërshtimin e privatizimit të egër dhe nën tre, nevojën për planifikime afatgjate.

Tash, 20 vjet nuk është bërë asgjë, kundërshtimet i kemi bërë të gjithë. Tash, na lejoni kohë neve që 9 muaj ta rimendojmë një strategji afatgjate, nuk jemi ne, e kemi kundërshtuar edhe Contour Globalin, e ka kundërshtuar edhe LDK-ja, kanë kundërshtuar edhe grupet e tjera parlamentare. Arsyeja është sepse në Contour Global qytetarëve të Kosovës nuk u keni treguar që fatura e tyre e energjisë rritet për 60%. Pra, nëse dikush paguan 100 euro energji, me Contour Globalin është dashur të pagujë 160 euro energji. Nuk qëndron argumenti që 'jo po në atë kohë e kemi pas menduar', e vërtetë është Contour Globali është menduar në vitin 2017, punët për Contour Globalin është dashur të fillonin në vitin 2018. Zoti Haradinaj ka qenë në pushtet deri në vitin 2020, pse nuk ka përfunduar atëherë? Arsyeja ka qenë që në fillim Contour Globali s'ka pasur likuiditet dhe është tërhequr me mungesë të likuiditetit. Pra, ne i kundërshtojmë dhe do të vazhdojmë t'i kundërshtojmë çdo projekt, i cili e rrit në mënyrë të paqëndrueshme faturën e energjisë, në të njëjtën kohë, në strategjinë e ardhshme, zoti zëvendëskryeministër, ministre e Energjisë, fokusi duhet të vendoset te renovimi i Kosovës A. E dyta, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme. E treta, minimizimi i humbjeve.

Zoti Hoti pati një deklaram sa i përket minimizimit të humbjeve, është e vërtetë që 30% e energjisë në Kosovë humbet. Por, autoriteti që i rregullon humbjet është Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë në vitin 2019 dhe në vitin 2020, në fakt, ia ka rritur shkallën e humbjeve KESCO-s dhe KEDS-it. As ZRRE-në nuk e kemi caktuar ne, as Qeveria Kurti, atë e ka caktuar Qeveria AAK dhe LDK.

Në fund, nevoja po ashtu është integrimi i plotë dhe shkëmbimi i energjisë në kuadër të bllokut energjik me Shqipërinë, por të rëndësishme janë alternativa të reja, e sidomos energjia e ripërtëritshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Dy replika i kemi dhe pastaj mund të shkojmë në votim. A bën, ministre, e fundit ta marrësh fjalën ti, nëse ka mundësi?

Së pari po ia japim fjalën Hykmete Bajramit, e ka pasur një replikë lidhur me diskutimin e deputetit Muja.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Zoti Muja, je shumë gabim kur thua që privatizimin e distribucionit e ka përkrahur Haki Shatri në emër të LDK-së. Haki Shatri veç në emër të LDK-së nuk ka pasur mundësi ta përkrahë, se komplet Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë kundër atij privatizimi prej 26.3 milionë euro dhe kemi qenë në opozitë në atë kohë.

Domethënë, kjo është e vërteta dhe mos manipulohet. Në anën tjetër, ju sa herë, brenda fjalimit, veç ishit kontradiktore disa herë. Thatë që nëse flitet për ZRRE-në në periudhën kur ju nuk keni qenë në pushtet, e paskan kontrolluar pushtetet dhe ministrat e kaluar. Ndërkohë, që për këtë ZRRE-në që është sot gjatë gjithë kohës ju dhe deputetët e tjerë, edhe ministrja gjithashtu tha që çmimin nuk e ngrit Qeveria, e ngrit ZRRE-ja.

Domethënë, sot qenka e pavarur që e keni caktuar ju, atëherë paska qenë e kontrolluar prej ministrave. Dhe, gjithashtu folët për rezolutën e Lëvizjes Vetëvendosje, e cila qenka sjellë nga partitë opozitare dhe interpelancat që i paskemi pasur në kohën kur kemi qenë në opozitë së bashku dhe sigurisht deshët të thoshit që ajo rezolutë nuk ka kaluar. Por, mua më intereson pse ju nuk e keni kaluar rezolutën tani, kur e keni shumicën absolute, e keni Qeverinë, i kontrolloni krejt institucionet dhe po të kalojnë pikat në Kuvend nganjëherë me 70 vota, bashkë me Listën serbe, po arrini t'i keni deri në 70 vota.

Po flasim për krizën energjetike sot, unë dola më herët dhe thashë jemi përgjegjës të gjithë ne që u kemi takuar qeverive të kaluara që nuk kemi arritur t'i shtyjmë përpara projektet e mëdha energjetike, se kemi rënë nën ndikimin e kundërshtimeve të opozitës dhe të shoqërisë civile, por ju nuk po e merrni asnjë përgjegjësi. Andaj, kjo kërkohet nga ju. Keni dalë në 2019 në 20 prioritete, keni pasur uljen e çmimit të energjisë, a nuk e keni ditur atëherë që çmimet i cakton ZRRE-ja, por keni menduar që i caktoni vetë. Sot kur erdhët, e lëshuat bajrakun!

**KRYETARI:** Një minutë kundër-replikën e ka zoti Muja!

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar i Kuvendit!

Dhe këtë mund ta verifikoj edhe Administrata e Kuvendit, më datë 8 tetor 2008, Grupi Parlamentar i LDK-së, Haki Shatri, në emër të LDK-së, se procesi i privatizimit ka filluar më 2008, është konkluduar në vitin 2012, por në atë kohë midis 2008 dhe 2010, LDK dhe PDK kanë qenë në pushtet dhe Haki Shatri më 8.10.2008 del thotë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së se ne e përkrahim këtë proces.

Pastaj, në vitin 2010 është tërhequr nga koalicioni, ka mundësi që pasi s'kanë qenë në pushtet vërtet e kanë kundërshtuar, por në indicie kur është bërë grupi punues, në fakt e kanë përkrahur parimisht.

**KRYETARI:** Besnik, në çfarë kategorie e ke kërkuar fjalën? Për debatin? Cilin debat? Debatin tënd që e ke pastaj? Urdhëro? Veç zoti Kokaj po pretendon që e ka pasur të drejtën edhe për një kundër-replikë, se ia ka përmendur emrin Xhavit Haliti.

**JAHJA KOKAJ:** Vetëm dua të referohem në komentimin e deputetit Haliti, i cili përmend emrin tim dhe frigoriferin. Meqë ai me dashamirësi e tha, edhe me dashamirësi e kuptova, por ...

KRYETARI: Më duket që ai tha pajtohem me zotin Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Meqë unë e them që akumulimi i energjisë elektrike bëhet në formën e polarizimit në elektrolit. Në asnjë formë tjetër kur është fjala për akumulimin e energjisë në bateri. Dhe, se tendencat e njerëzve që të ma kapin fjalën në kuptimin e ortografisë, ortopisë ose në forma stilistike e tjera, të veçuara për të degraduar, nuk kanë sukses për arsye se këto procese i njoh fort mirë dhe se kjo është ajo për të cilën desha ta sqaroj në mënyrë eksplicite dhe të ndritshme. Faleminderit!

KRYETARI: Besnik Tahiri dhe po shkojmë në votim.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi thirrur në debat, të cilin presim ta mbajmë, thirrësi, në këtë rast kryetari Haradinaj dhe ne si grup parlamentar u mundova të kërkoj një mirëkuptim, edhe prej kolegëve të mi të partive opozitare, por nuk ndodhi, atëherë kërkesa ime, pasi po shkojmë në pushim, të mund të kthehemi në orën 16:00. Faleminderit!

KRYETARI: A bën në 15:30, sepse shumë në 16:00? Mirë! Ministre, a e do fjalën përfundimtare, përmblyëse, të këtij diskutimi që e patëm për vendimin e Qeverisë?

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit të gjithëve për komentet dhe pyetjet shtesë. Po e filloj aty ku e lashë herën e kaluar, kur u harxhua koha. Që dy ditë nuk është dashur të ketë reduktime, nëse ka pasur reduktime, atëherë nuk është dashur të ndodhë kjo. Ftoj ZRRE-në të hulumtojë të gjitha ankesat për reduktime më të gjata, të gjitha të cilat i kemi marrë nga konsumatorët.

Gjithashtu, ka pasur edhe ankesa se nuk kanë punuar të gjitha fazat në shumë lokacione, për këtë ne jemi duke përgatitur edhe një dosje, të cilën do ta dorëzojmë në polici, mirëpo presim edhe nga ZRRE-ja që të bëjë punën e saj dhe të hulumtojë se çfarë është duke ndodhur. Si dhe, faktin që siç thashë, ne kemi dyshime që këto dy kompani, KEDS-i dhe KESCO, nuk janë duke punuar si të pavarura sipas ligjit, mirëpo kemi dyshime që janë duke ndërvepruar dhe të gjitha këto e kanë vështirësuar ndërhyrjen tonë për të rregulluar situatën në treg. U tha, keni bërë marrëveshje me KEDS-in, atëherë i keni në dorë, pse nuk po mund t'i kontrolloni. Jo, në fakt, nuk kemi bërë marrëveshje me KEDS-in, ne kemi bërë marrëveshje me KEK-un, KEK-u ka bërë marrëveshje me KESCO-në, siç e thashë, për të mbuluar shpenzimet për konsumatorët. Ndërsa, kemi konsideruar se humbjet e rrjetit, në të cilat deri tani KEDS-i që nga privatizimi është dashur të investojë e të ulen dukshëm, e nuk janë ulur, duhet t'i mbajnë ata vetë, dhe nuk kemi as për afërsisht qasje dhe autoritet përmbi KEDS-in si kompani private, sikurse që do të kishim pasur ose që keni ju si Kuvend ose ne si Qeveri mbi kompanitë publike.

As nuk kemi qasje në llogaritë e tyre, për të ditur nëse ata me të vërtetë kanë probleme likuiditeti, as nuk kemi qasje në borde dhe menaxhmentin e tyre, po të ishte një kompani publike KEDS-i dhe të ndodhnin ato probleme që kanë ndodhur gjatë ditëve të reduktimeve, po të kishin ardhur ato ankesa, do të ishte shumë e lehtë dhe besoj që bordi do të shkarkohej menjëherë ose bordi do ta shkarkonte kryeshefin menjëherë, sikur të kishte qenë kompani publike.

Kjo është detyrë, kompetencë e ZRRE-së. Unë edhe një herë e ftoj ZRRE-në dhe mendoj që secili prej nesh duhet ta bëjë që të shohë në secilin rast nëse të gjitha kompanitë të licencuara nga ZRRE-ja kanë qenë në krye të detyrës dhe i kanë përmbushur obligimet e tyre sipas licencës së vet. Këto procese marrin kohë, për herën e kaluar kur është dënuar për reduktimet e vitit të kaluar, kur është dënuar KEDS-i, 4 reduktime të paplanifikuara që kanë zgjatur më shumë, ZRRE-së i janë dashur 4 muaj që ta hulumtojë rastin, ta vërtetojë dhe të japë dënimin e merituar. Ndërkohë që ne po flasim për një gjendje emergjente që nuk e bën aspak të lehtë menaxhimin e situatës.

Thatë se ju si ministri, ju si Qeveri nuk blini energji, por i bëni vlerësimet, pajtohem, nuk blejmë energji, në fakt, edhe vlerësimet nuk i bëjmë ne, i bëjnë operatorët e tregut dhe ZRRE-ja, mirëpo unë i kam kërkuar si ministre, siç e thashë më datën 2 nëntor e kam formuar këtë task-forcën, e cila e ka bërë raportin brenda 3 javësh. Situata është përkeqësuar dukshëm, si përbrenda për nga blloqet që i kemi pasur në operim, edhe nga jashtë, nga çmimet e importit dhe si rrjedhojë gjendja ka qenë shumë më e keqe. Për të ilustruar, kur e ka bërë para një muaji vlerësimin task-forca, planifikimi ka qenë që me 13 milionë euro të mbulohet i tërë subvencioni për import për muajt nëntor dhe dhjetor, përderisa vetëm gjatë muajit nëntor dhe fillimit të dhjetorit kjo kosto veçse është tejkaluar që ilustron seriozitetin e situatës dhe sa është përkeqësuar nga planifikimi deri në ditën ku jemi sot.

Masat emergjente, u tha, flasin vetëm për kufizime, jo nuk është e saktë. Nuk flasin vetëm në kufizime, por flasin edhe për obligime të veçanta, të cilat u jepen ndërmarrjeve të caktuara në kohë krize. Gjithashtu, flasin për mbrojtjen e grupeve të konsumatorëve gjatë krizave. Pastaj, u përmend projekti i MCC-së prapë, duke akuzuar se fakti...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** A mund ta përmbledhësh fjalën gjithçka që ke për të thënë për 60 sekonda, e nderuar ministre? Jo! Kjo është një shkathtësi shumë e nevojshme këtu në Parlament. Mirë, pasi je në Qeveri, e nuk je në Parlament, po ta lejojmë edhe një minutë shtesë, nëse ka mundësi.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Për çështjen e gazit kam folur disa herë kështu që po e kaloj krejt, meqë nuk kemi debat do ta ndaj me ju një pjesë të fjalimit, të cilin e kam paraparë për debat e kjo është fokusi në të ardhmen.

Çfarë jemi duke bërë paralelisht me menaxhimin e krizës është që jemi duke marrë hapa të menjëhershëm ose duke vazhduar punët që veç kanë filluar në disa aspekte. Gjatë vitit që vjen do të vazhdojnë punët e nisura në kornizën rregullative dhe ligjore për burimet e ripërtërishme të energjisë, lansimin e ankandëve të para për BRE, rritjen e kapaciteteve të KEK-ut përmes inkuadrimin të 100 megavatëve të energjisë solare, heqjen e barrierave për bizneset që të investojnë në panele solare, duke mundësuar që ato për nevoja të veta të prodhojnë energji dhe, në këtë mënyrë edhe ta kenë koston më të ulur të energjisë elektrike, por edhe të mos ndikohen kaq shumë ndaj ndikimeve të jashtme, kjo kërkesë vjen nga vetë bizneset. Në strategji të energjisë jemi duke shqyrtuar investimet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ministre, me sa po e shoh, ti e ke konceptuar këtë fjalë për të gjitha planet e Qeverisë në të ardhmen, por këtu e keni sjellë ju një vendim shumë konkret për ta votuar, për të cilin u fol deri tash për disa orë këtu. Kështu që... qysh debat? Debati vjen pastaj i AAK-së prej orës 15:30, aty do ta keni të gjithë kohën e mjaftueshme për t'i shpjeguar të gjitha këto që po i thoni.

Tash po hyjmë në votimin e vendimit të Qeverisë, nëse ka mundësi.

Faleminderit, ministre!

81 deputetë janë të pranishëm.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, ju lus që me ngritje të dorës të deklarohemi për Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Kuvendi nuk ka kuorum për ta marrë këtë vendim, vetëm 55 deputetë kanë votuar.

\* \* \*

*E mërkurë, më 29 dhjetor 2021*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

**KRYETARI:** Fjalën e ka kërkuar kryetarja e Grupit të Vetëvendosjes. Përderisa kjo të ndodhë, neve na duhet edhe një konsultim me grupet parlamentare, me kryetarët e grupeve.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit, kryetar!

Për shkak se ne i filluam punimet e seancës së mbetur të 24 dhjetorit, përderisa e kemi edhe një vendim i cili nuk u hodh në votim sot, i seancës së jashtëzakonshme të mbajtur dje: Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës për furnizimin e energjisë.

Unë do të doja të propozoja që aktualisht të votojmë, të procedojmë me votimin e këtij vendimi i cili e ka afatin deri ditën e premtë. Sipas Ligjit mbi energjinë, ky vendim pas sjelljes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Kuvendi ka shtatë ditë kalendrike që ta miratojë këtë vendim.

Prandaj, kërkoj edhe nga grupet e tjera parlamentare të mbështesin kërkesën që ne të procedojmë me votim, për shkak se edhe debati për këtë pikë është konsumuar, ka mbetur vetëm procesi i votimit. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Po besoj që janë kushtet që të hedhet në votim, përndryshe pra me të vërtetë nëse kalon afati dhe Qeveria nuk do të mund pastaj nëse ndërlikohet situata edhe më tutje energjetike, nëse nuk mund të marrë masa, besoj që do të jetë keq për të gjithë qytetarët e Kosovës, prandaj.

T'ua japim fjalën edhe kryetarëve të grupeve. Arben Gashi e ka fjalën.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përkundër vullnetit tonë pozitiv të deklaruar dje dhe angazhimit tonë, situatën e krijoj papërgjegjshmëria e sjelljes së ministrit të Financave, i cili doli në Kuvend dhe iu drejtua Kuvendit se Kryeministri e konsideron të parëndësishëm të bisedojë me Kuvendin për këtë çështje. Kjo është ajo arsyeja që ne dje e lëshuam seancën, sepse ishte ofendim për Kuvendin. Një vendim të Qeverisë, jetik, i cili ka të bëjë për furnizimin e qytetarëve me energji elektrike, të dalë ministri i Financave në emër të Kryeministrit dhe Qeverisë, të thotë që e konsideron të parëndësishëm të bisedojë me Kuvendin kur duhet votuar për atë vendim, është papërgjegjësi totale.

Prandaj, unë e konsiderova si një sjellje ofenduese për Kuvendin dhe Grupin Parlamentar të LDK-së dhe e lëshuam seancën dje. Unë e kuptoj rëndësinë, e kuptoj emergjencën. Nuk pajtohem me mënyrën se si është ndërtuar vendimi. Ka plotë elemente që mungojnë në atë vendim. Ka elemente të cilat duhet t'i trajtojnë edhe çështjet e mundësive të aktivitetit kriminal

që mund të ketë ndodhur në këto institucione që e rregullojnë sistemin energjetik në Kosovë, qoftë KEK, ZRRE, KOSTT apo kudo tjetër. Pra, është dashur të jetë më i begatshëm ai propozim aty.

Është në dorën e juaj si shumicë që ta merrni këtë vendim. Ne si grup parlamentar nuk do ta bllokojmë procesin, por nuk do të marrim pjesë në votim. Pra, mospjesëmarrja jonë në votim, ju jep mundësi juve që ta kaloni. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Dje patëm një debat pothuajse rreth shtatë orë sa i përket kësaj çështjeje dhe realisht pamë një papërgjegjësi goxha të madhe të kësaj Qeverie. Kërkesa jonë dhe e gjithë deputetëve të opozitës ishte që të jetë prezent edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës në këtë seancë, sepse konsiderojmë që nuk ka gjë më të rëndësishme në këtë periudhë sesa gjetja e alternativave të tjera për furnizim me energji elektrike për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne edhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, përmes deputetit z. Ferat Shala, kemi kërkuar që një gjendje e tillë të shpallet sa më herët. Jemi vonuar shumë, mirëpo ka qenë një pikë të cilën ne e kundërshtojmë nga ky vendim që e kam thënë edhe dje. Pra, largimin e kufizimeve të energjisë elektrike për konsumatorët, gjegjësisht për qytetarët e Republikës së Kosovës. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ne do të marrim pjesë në votimin e këtij mocioni procedural që t'ju japim pastaj juve mundësi që ta kaloni këtë vendim. Mirëpo, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike nuk mund ta votojmë këtë vendim pra për masat emergjente për furnizim me energjinë, pa u larguar kjo pikë. Mirëpo, e përkrahim edhe opsionin që të jetë në rend dite, pastaj vendosni ju. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ta marrim edhe mendimin edhe të dy grupeve të tjera parlamentare, pastaj vendosim. Fillimisht ia japim fjalën Grupit të AAK-së, Besnik Tahiri, kryetar i grupit.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Ne jemi deklaruar dje dhe po rideklorohemi sot. Vendimin e Qeverisë e shohim si një vendim i cili nuk ka efekte në terren. Është një vendim i cili më së paku ka qartësi. E krijon edhe një grup punues, për të cilin nuk kemi parë një arsyeshmëri të saktë se cila do të jetë detyra dhe çka do të ndihmojë qytetarët e Kosovës, përveçse pikave që kufizojnë, nene që kufizojnë Qeverinë në veprime dhe njëkohësisht masave që do t'i ndërmarrin dhe mos penalltitë që do t'i marrin në qoftë se bëjnë reduktime të rrymës.



Megjithatë, duke pasur parasysh se gjendja është emergjente dhe ne e kemi thirrur debatin për krizën energjetike, ne edhe dje kemi marrë pjesë në votim dhe kemi abstenuar. Edhe sot e votojmë mocionin dhe marrim pjesë në votim dhe abstenojmë.

Pra, ta qartësojmë, kur ka tema të tilla, d.m.th. ne marrim pjesë, kur ka marrëveshje ndërkombëtare, ne votojmë. Por kërkojmë, në veçanti nga Qeveria, shikoni ministri i Financave dje e ka provokuar daljen e një grupi parlamentar prej seance, me qasjen e tij. Kjo nuk bën të ndodhë. Pa marrë parasysh se mund ta kesh një shumicë, nuk bën të ndodhë, nuk duhet të ndodhë.

**KRYETARI:** Tash e marrim fjalën edhe të Grupit Multietnik.

**ENIS KERVAN:** Faleminderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar e mbështesim propozimin e Grupit Parlamentar Vetëvendosje për vendimin e Qeverisë. Dëshiroj, në qoftë se më lejoni, që të mos marrë edhe njëherë fjalën, pasi që shpesh kaluam te propozimi i Grupit të Vetëvendosjes, të shprehë edhe mendimin për pikën paraprake për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, edhe pas pauzës në qoftë se e vendosim për çështje të Zyrës Ligjore dhe teknikisht për ta shikuar qëndrimin çka do të ndodhë për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për komunitetin serb, ne mendojmë që për anëtarë të komuniteteve joserbe, i plotësojmë kushtet dhe dëshirojmë që sot të hedhet në votim, kur bëhet fjala për anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe joserbe.

**KRYETARI:** Pra, kemi propozim që ta hedhim në votim vendimin, i cili ishte nga ana e Qeverisë dhe i cili ka të bëjë.

S'po di a kemi nevojë për mocion procedural. A kemi nevojë mocion procedural për të hapur një seancë të cilën nuk e kemi mbyllur a? Jo, këtë mund ta ndërpresim.

Urdhëro, Arben Gashi!

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, një deputet apo grup parlamentar ka të drejtë në çdo moment të propozojë mocion procedural urgjent. Pra, në këtë rast, po propozohet një mocion procedural urgjent për t'u marrë një pikë nga një seancë tjetër dhe për t'u trajtuar sot për shkak të karakterit urgjent. Pra, duhet të votohet mocioni procedural, pastaj të votohet vendimi si i tillë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kështu, kalojmë në mocionin e ngritur nga Grupi i Vetëvendosjes.

Kush është për këtë mocion? Kush është kundër? Kush po abstenon?

Konstatohet që nga 95 deputetë sa kanë marrë pjesë sa janë të pranishëm, 77 kanë votuar për këtë mocion, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Konsiderohet që mocioni u miratua. Kështu që mund të kalojmë në votim e kësaj pike që është pra: Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës për furnizim me energji.

Vendimin e keni pasur përpara. Për këtë është edhe diskutuar ditën e djeshme. Kështu që të gjitha diskutimet janë shteruar, nuk ka pasur kuorum. Tash po konsiderohet që ka, janë krijuar kushtet objektive që ta hedhim edhe njëherë në votim.

Kush është, të deklarojeni me ngritje të dorës të nderuar deputetë, për Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës për furnizim me energji?

Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 57 vota për, asnjë kundër dhe 17 abstenime, konstatohet që Kuvendi e miratoi vendimin e Qeverisë së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë dhe me këtë konstatohet po ashtu që seanca e cila ishte thirrur prej dyzet deputetëve është konsumuar përmes këtij votimi dhe përmes këtij mocioni procedural, logjikisht.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*